



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Menaxhim”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Fan.S.Noli”,
Korcë”


Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Dr. Ana Kapaj
2. Prof.Asoc. Genc Alimehmeti

Janar/2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT:**Bachelor në "Menaxhim", ofruar nga Universiteti "Fan S. Noli" Korçë,**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Fan S. Noli", Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Menaxhimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Menaxhim
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 586, date 07.07.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Regjistrimi i formës së diplomës:	UMAS Nr. 323, datë 05.06.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	27/1
18	Numri i studentëve:	126 studentë
19	Komente / të tjera:	-




TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Fan S. Noli në Korçë, është një nga universitetet publike më të konsoliduar në Shqipëri, themeluar në vitin 1992. Pikërisht në këtë vit është hapur edhe Fakulteti i Ekonomisë si njësi kryesore që ofron këtë program studimi.

Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim” synon arsimimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e menaxhimit të biznesit duke synuar të pajisë studentët me njohuritë themelore në këte fushe nëpërmjet integritit të mësimit me kërkimin. Programi synon të zhvillojë aftësitë, shprehitë dhe kompetencat e studentëve për tu bërë ekspertë të denjë të fushës së menaxhimit të bizneseve. Ky është një program mjaft i rëndësishëm për tregun rajonal të punës.

Për të gjitha ciklet dhe për të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Ekonomisë janë bërë ndryshime dhe përshtatje të kurrikulave të studimit ndër vite. Këto ndryshime janë diktuar nga nevoja e tregut të punës por edhe nga kushtet e vendosura nga udhëzimi i Ministrisë së Arsimit Sporteve dhe Rinisë për raportet e lëndëve të detyrueshme dhe me zgjedhje. Këto përshtatje në kurrikulën e studimit kanë qënë të nevojshme edhe për të përshtatur studentin në terma të kompetencave, aftësive dhe njohurive të marra gjatë studimeve me kërkesat e tregut të punës në Shqipëri por edhe jashtë saj. Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim” ofrohet nga departamenti “Menaxhim” në Fakultetin e Ekonomisë, në Universitetin Fan S. Noli të Korçës. Miratimi i këtij programi studimi është bërë me VKM Nr.230, datë 29.05.1992.

Rëndësia e këtij programi përmbliidhen në pikat e mëposhtme:

- Rëndësia e këtij programi është e madhe për shkak të testimit në treg për një kohë të gjatë, reflektimit në kurrikula të asaj çka ka kërkuar dhe nevojitur tregu, apo sepse studentët e këtij programi jo vetëm që priten të jenë një burim i rëndësishëm ekspertësh/specialistesh, por do të plotësojnë qartë nevojat që kanë tregu shqiptar kundrejt rritjes së këtij trendi.
- Rëndësia e këtij programi është gjithashtu ndërkombëtare, sepse përputhet qartë edhe me politikat e komunitetit europian.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim” filloi me prezantimin dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm në lidhje me shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga IAL dhe përgatitjen e raportit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj procedure u identifikuan dhe u listuan pyetje në lidhje me standarde dhe kritere përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita 2 ditore në Universitetin Fan S. Noli, Korçë, u realizua gjatë datave 12-13.10.2020, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shoqëruar nga koordinatori teknik i ASCAL, i caktuar për këtë program studimi, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL. Gjatë kësaj vizite 2-ditore Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me Rektorin, Dekanin e FE dhe Përgjegjësen e Departamentit, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi si dhe vizitoi zyra të caktuara të këtij institucioni dhe mjediset e FE. Gjatë këtij takimi u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe çështje për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse.

Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë Institucion. Në përfundim të këtij procesi GVJ dorëzon raportin tek Koordinatorin Teknik i ASCAL. Gjatë gjithë procedurës ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Koordinatorin Teknik i ASCAL.

Më datë 08.01.2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 02/01 Prot., datë 08.01.2021, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes sistemit AMS, më datë 15.01.2021 dhe me shkresë Nr. 2/2 Prot., datë 18.01.2020.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. **Për komentin e institucionit mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.5, Kriteri 2 :** GVJ, shpreh bindjen e saj se ky konstatim është i saktë. Gjithashtu dhe IAL në komentet e sjella shprehet se ky konstatim është i saktë. Ndërkohë GJV në asnjë moment nuk është shprehur në lidhje me faktin se ky staf është personel akademik efektiv i UK apo i jashtëm lidhur me Fakultetin e Ekonomisë. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
2. **Për komentin e institucionit mbi konstatimin e GVJ në Standardin IV.4, Kriteri 4 dhe 5:** GVJ Duke marrë parasysh komentet mbi Draft RVJ, Bsc në “Menaxhim” dhe Shtojca 1, praktika për shtimin e titujve të bibliotekës, konstatohet një listë e gjërë titujsh me interes për programin e menaxhimit (si p.sh., innovation and entrepreneurship, managerial accounting, public finance, etj.). **Raporti në këtë pikë ndryshon.**
3. **Për komentin e institucionit mbi konstatimin e GVJ në Standardin IV.6, Kriteri 3 dhe 4:** GVJ, duke marrë parasysh komentet mbi Draft RVJ. Bsc në “Menaxhim”, referencat e dokumentave të vendosura në dispozicion mbi raportimin financiar dhe auditimin financiar nga KLSH, konstatohet se edhe pse raportet ndodhen si dokumenta ne serverin e faqes web të UK, GVJ nuk arrin dot të identifikojë një seksion të qartë dhe të aksesueshëm nga një përdorues normal i faqes., **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Menaxhim”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</p> <p>Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> <p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Universiteti i Korçës F.S.Noli (referuar më poshtë si UK) është institucion publik i arsimit të lartë (IAL) që financohet nga shteti dhe burime të tjera të ligjshme (Aneks I.01 Statuti UK).</p> <p>Ai është institucion i arsimit të lartë (IAL) që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese profesionale dhe të transferimit të dijeve të tretët (Aneks I.01 Statuti UK).</p> <p>Synimi kryesor i UK, Fakultetit të Ekonomisë dhe i programit të studimit Bachelor në “Menaxhim” që bën pjesë në këto struktura, është të ofrojnë arsimin të lartë, zhvillim të dijeve dhe shkencës, inovacionit dhe të profesioneve të ligjshme (Aneks I.01 Statuti UK).</p> <p>UK ka për mision “edukimin profesional dhe kërkimin shkencor me qëllim krijimin e specialistëve të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit...të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social e kulturor në nivel rajonal e kombëtar”</p> <p>Veprimtaria kërkimore-shkencore në UK, zhvillohet në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Ajo synon t’u paraprijë dhe t’u japë përgjigjet sfidave të zhvillimit dhe të integritetit të vendit në strukturat evropiane, shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, rritjes së prodhimit vendas dhe njëkohësisht zgjerimit të llojshmërisë dhe të vëllimit së eksporteve, rritjes së konkurrencës, etj., (Aneks I.01 Statuti UK).</p> <p>Programi i studimit në të gjitha dokumentat e ofruara, por edhe nga vizita në institucion reflekton praninë e të gjitha objektivave të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe analitike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Ky program synon pajisjen me njohuritë bazë mbi menaxhimin dhe ka një përmbajtje të tillë që t’u ofrojnë studentëve njohuritë bazë të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit. (Aneks I.02, Aneksi I.19).</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim” plotëson kriteret sa i takon rëndësisë së programit për nevojat e ekonomisë, organizimit dhe administrimit të tij nga një staf i kualifikuar, nga kompetencat që ai përcjell, si dhe sa i takon mësimdhënies, mësimnxënies, si dhe plotësimit të burimeve të nevojshme për realizimin me cilësi të programit të studimit. Studentet e këtij programi fitojnë njohuri të menaxhimit, ndaj përshtaten më së miri me kërkesat e tregut në këtë fushë. Ata mund të punësohen si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - menaxherë në ndërmarrjet dhe biznese të ndryshme; - në agjenci të ndryshme shtetërore; - në institucionet e sistemit bankar dhe ato të mikrofinancës; - në institucione politikbërëse në nivel qëndror dhe atë lokal; - në institucione apo agjenci të tjera publike ose private;

	- në sektorin privat, banka, institucione të administratës qendrore dhe vendore etj. Plotësimi i këtij kriteri sigurohet gjithashtu edhe nga respektimi i Legjislacionit në fuqi, në mënyrë specifike i ligjit Nr. 80/2015 datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe rregulloreve të tjera të brendshme.			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Ky program studimi jo vetëm për koherencën, rëndësinë dhe jetëgjatësinë në tregun e arsimit të lartë publik shqiptar, por edhe për rëndësinë dhe qasjen ekonomike që ka në kuadrin dhe rëndësinë kombëtare, paraqitet me rëndësi strategjike për ekonomine rajonale dhe tregun e rajonal të punës dhe nevojat e biznesit. Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim” përmban objektiva të qarta dhe synon të jetë vendosur në dritën e perspektivave të zhvillimit ekonomik të rajonit. Përmes një kurrikule mjaft të qartë synohet të arrihet përgatitja e specialistëve të të nesërme që të mund ti shërbejnë sa më mirë zhvillimit rajonal të zonës por jo vetëm. Nëpërmjet një kurrikule në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, studentet fitojnë kompetenca profesionale për të marrë vendime dhe në përshtatje me situatat reale konkurruese të tregut.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Përcjellja e një filozofie shkencore, funksionale midis njësive bazë dhe atyre mbështetëse, e mbështetur përmes dokumentacionit të bollshëm dhe cilësor, departamentit të përkushtuar dhe në kërkim të standarteve dhe qasjeve të reja ndërkombëtare, vëmendjes ndaj studenteve dhe mbështetjes për biznesin dhe nevojën e pasjes së tij në krah, përbëjnë disa ndër treguesit e identifikuar në të gjithë procesin e vlerësimit të këtij programi. Institucioni ka të përcaktuar përmes dokumentacionit si strategjitë, statutin, rregulloret e përgjithshme dhe ato të brendshme si njësi operative që lidhen dhe ndërvaren me njëra tjetrën në funksion të mirëshërbimit të objektivave kryesore në funksion të të cilave funksionon edhe ky program studimi. (Aneksi I.01, I.02, I.03)
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	E analizuar nga dokumentacioni i venë në dispozicion, por edhe nga vizita dhe takimet me grupet e interesit, rezulton se ka një përputhshmeri midis asaj çka rregullorja dhe dokumentacioni tjetër i venë në dispozicion nga UK me atë çka përcillet apo identifikohet në terren. Kështu, në planin strategjik për zhvillimin e UK-së vendosen disa prioritete midis të cilave janë studentët, kërkimi dhe mësimdhënia. Plani strategjik përbën një plan konkret për të ndërtuar realitetin e UK dhe përbën një pikë të fortë orientuese për të ardhmen. Kështu, në Planin Strategjik, në Statutin dhe rregulloren e studimeve universitare të UK, janë përcaktuar qartë të gjitha drejtimet prioritare akademike e si i tillë është dhe programi Bachelor në “Menaxhim”, i cili në këtë frymë ndër të tjera synon të sigurojë nivel njohurish në shkencat ekonomike për menaxhimin e bizneseve, të përmirësojë cilësinë, rrisë aftësinë praktike, të forcojë orientimin me tregun, kompetencat akademike, profesionale, apo etike të komunikimit. (Aneksi I.19)
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe	Në vijueshmëri të zbatimit dhe përputhshmërisë me atë çka vendos institucioni në dokumentat themelore, si Statuti, Plani strategjik apo rregullorja, vijnë natyrshëm

përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	edhe dokumentacioni që njësia bazë e këtij programi, pra departamenti ndjek për të realizuar këtë përputhshmëri. Në përputhje me Strategjinë e UK, dhe Rregulloren e FE, departamenti u ofron studentëve programin e studimit në fushën e menaxhimit, në ciklin e parë Bachelor në "Menaxhim". Veçori e këtij programi studimi është përgatitja e menaxherëve të biznesit me njohuritë e përgjithshme të menaxhimit, profilizuar në biznes dhe që janë të aftë të integrohen lehtësisht në tregun e punës në profile të ndryshme biznesi. (Aneksi I.19) (Aneksi I.01, I.02, I.03)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Departamenti si njësia bazë që ofron këtë program studimi krahas objektivave për t'i shërbyer tregut dhe biznesit shqiptar, rritjes së cilësisë dhe përmirësimit të standarteve të mesimdhënies, forcimit të marrëdhënieve me studentet, qëndëron dhe vlerëson në mënyrë të vazhduar formimin e studentëve të këtij programi me ato aftësi, dije e kompetenca që i shërbejnë tregut, objektivave të programit dhe institucionit. Këto studime synojnë formimin dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e menaxhimit. Studimet në këtë program synojnë të sigurojnë njohuritë themelore në këto fusha nëpërmjet integritit të mësimit me kërkimin. Po ashtu programi i studimit synon të sigurojë nivel njohurish në shkencat e menaxhimit dhe marketingut që të jenë të krahasueshme me diplomat që lëshojnë strukturat analoge universitare jashtë vendit. Program i studimit Bachelor në "Menaxhim" ka përmbajtje të tillë që u ofron studentëve njohuritë bazë të nevojshme për ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit. (Aneksi I.21)
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Fakulteti i Ekonomisë ka një përvojë të gjatë akademike duke filluar që me krijimin e tij në vitin 1992, ku studentët e parë u diplomuan në vitin 1996. Njësia bazë e ofrimit të këtij programi përbën një departament të konsoliduar ku qasja ndaj tregut, studentit, cilësisë dhe orientimit ndërkombëtar kanë qënë dhe mbeten ende jo vetem objektiva dhe synime të qarta, por të realizuara dhe testuara në mënyrë të sukseshme dhe qëndrueshme në tregun shqiptar. Në mënyrë të vazhduar kjo njësi ka kryer studime të ndryshme cilësore e sasiore për të testuar tregun, përputhshmërinë e programeve, afërsinë me biznesin pavarësisht sfidave dhe vështirësive. (Aneksi I.22, Vizita në IAL) Rezulton nga vizitat në IAL, diskutimet me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe me grupin e përgatitjes së raportit të vlerësimit të brendshëm, por edhe nga dokumentacioni bashkangjitur (Aneksi I.22, Vizita në IAL), se: është realizuar studimi për këtë qëllim, ku targeti i studimit janë studentët e UK-së. Qëllimi i vendosjes së kontakteve midis studentëve dhe biznesit është jo vetëm venia në kontakt e studentëve me punëdhënësit potencialë, por edhe përshtatjen e kurrikulave dhe programeve në përputhje me tregun e punës.
Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve	Kjo realizohet kryesisht mbi bazën e kurrikulës dhe metodologjisë së përdorur në mesimdhënie. Kurrikula mësimore është e strukturuar në kategoritë e lëndëve sipas kriterëve të arsimit të lartë por edhe të përshtatur mbi bazën e gjetjeve të kërkimit të tregut në lidhje me kompetencat e kërkua në punësim si edhe mbi bazën e

përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	eksperiencave të fituara në projektet e universitetit dhe bashkepunimet me universitete të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. (Aneksi I.26, I.27, I.28)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4	
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	<p>Njësisia bazë e ofrimit të këtij programi studimesh përbën një departament të konsoliduar ku krahas qasjes ndaj tregut dhe rrjedhimisht dhe studentit, punohet për përmirësimin e cilësisë, mësimdhënies dhe mësimnxënies, përmirësimin dhe diversifikimin të metodave inovative të mësimin dhe vlerësimin të dijes. E gjitha kjo ka demonstruar dukshëm një përvojë, kapacitetet dhe burime cilësore dhe sasore për ofrimin e këtij programi studimi, duke bërë që kjo njësi bazë e këtij institucioni të ndikojë direkt në rritjen dhe imazhin e vetë UK.</p> <p>UK, është një nga IAL-të më të vjetra në Republikën e Shqipërisë. Kjo i ka dhënë mundësinë që në vite të krijojë një përvojë dhe një kapacitet burimesh njerëzore në fushën akademike në përshtatje me qëllimin kryesor të këtij institucioni, përcjelljen e dijes tek studentët.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë, ku ofrohet ky program studimesh, aktualisht ka një staf akademik të kualifikuar, që përbëhet nga 14 profesorë të asociuar, 14 doktorë shkencash, 4 studentë doktorature dhe 2 MSc. Personeli akademik, si pjesë e fakulteteve të tjera në UK, që mbulon disa prej disiplinave të programit të studimit Bachelor në "Menaxhim", mbështet rritjen e cilësisë së kurrikulës të studimit. Departamenti i Menaxhimit ka në përbërje të tij staf akademik të kualifikuar: 4 profesorë të asociuar, 4 doktor shkencash, 1 student doktorant dhe 1 MSc. Kualifikimi dhe përgatitja e stafit është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të Departamentit, si dhe me modulet që mbulohen prej tyre. Stafi akademik i Departamentit ka mesatarisht mbi 16 vjet përvojë pedagogjike dhe moshë mesatare 45 vjec.</p> <p>Vlen të theksohet se edhe politika e vazhdimësisë së stafit në UK/FE, ka inkurajuar krijimin e një stafi të specializuar dhe orientuar në profilin e bizneseve në sektorin e menaxhimit. Ky staf si rezultat i bashkëpunimeve me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare është kualifikuar në vijimësi.</p> <p>(Aneksi I.01), (Aneksi I.02), (Aneksi I.19), (Aneksi I.21), (Aneksi I.31)</p>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga IAL, por edhe nga verifikimet e kryera gjatë vizitës në institucion, konkludohet se ka një përputhshmëri të plotë dhe cilësore midis fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Menaxhim". Bazuar në dokumentacionin konkludohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> programi i studimit Bachelor në "Menaxhim" është program i ciklit të parë të studimit, organizohet në 180 kredite (ECTS), përkatësisht 60 ECTS në çdo vit akademik dhe kohëzgjatja normale e këtij programi studimi është tre vite akademike;

<p>direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • programi është në linjë me synimet dhe misionin e UK ; • emërtimi i programit të studimit, Bachelor në “Menaxhim” është i njëjtë me emërtimin e vetë Departamentit: Menaxhim. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Universiteti Korces përbën një IAL të mirëorganizuar midis njësisve bazë njësisve kryesore si dhe brenda tyre. Këtë organizim e reflekton: ndarja midis fakulteteve dhe marrëdhëniet brenda tyre; si dhe delegimi dhe përcjellja e procedurave, analizave vjetore nga poshtë-lart-poshtë ka rezultuar mjaft eficiente për departamentet si njësi bazë dhe mjaft të rëndësishme për vetë këtë IAL.</p> <p>Mbarëvajtja dhe mbikqyrja e programit të studimit bëhet në formë të koordinuar nga të gjitha instancat drejtuese të UK. Janë një sërë zyrash dhe njësisish përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor, si: Sekretaritë e Departamenteve, Zyra e Kurrikulave në Rektorat, Zv. Dekani për mësimin, Zv.Rektori për mësimin, etj. Një koordinim i punës së këtyre njësisve ka sjellë një mbështetje të studimeve në këtë cikël.</p> <p>Integriteti, cilësia dhe vlera që produkti i prodhuar nga departamenti i menaxhimit si ofruese bazë e këtij programi studimi është gërshetim jo vetëm i përkushtimit të stafit, përgjegjëses të departamentit, orintimeve të qarta të vetë IAL, por edhe të suportit së tyre përmes njësisve të tjera mbështetëse. Ndërgjegjësimi dhe orientimi drejt mësimdhënies dhe kërkimit shkencor bëhet paralel me përpjekjet për të ndërkombëtarizuar programin. Raportet me institucionet ndërkombëtare jo vetëm kanë rritur dhe përmirësuar imazhin dhe rëndësinë e këtij departamenti, por kanë ndikim direkt në promovimin, rritjen dhe ndërkombëtarizimin e të gjithë UK.</p> <p>Ndërsa raportet me institucionet dhe bizneset kombëtare mbeten prioritet, janë të shumta përpjekjet që bën i gjithë stafi i këtij departamenti i cili shfrytëzon lidhjet e veta edhe personale duke synuar t’u ofrojë studentëve përmes praktikave apo vizitave në biznese shqiptare, etj. Nga ana tjetër nga takimi me studentët rezulton se këto takime me biznese vendase apo të ftuar të huaj e vendas kanë qënë mjaft eficiente.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Një ndër sfidat kryesore të fakultetit dhe vetë këtij departamenti është rritja e procesit të ndërkombëtarizimit e cila do t’i shërbejë rritjes së standarteve dhe përmirësimit të cilësisë. Kjo sfidë ka ardhur me rritjen e kësaj njësie bazë, me testimin dhe vlerësimin pozitiv të outputit që ky departament nxjerr për tregun shqiptar, të vlerësimeve dhe mbështetjes nga bizneset shqiptare si dhe rritjes së nevojës se tregut për student cilësorë të këtij programi.</p> <p>Outputi i rezultuar nga analizat e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve ka prodhuar një perceptim dhe gjykim cilësor për të gjithë punën masive të bërë deri tani dhe me sigurinë e përputhjes me tregun. Raportet me institucionet ndërkombëtare kanë rritur dhe përmirësuar imazhin dhe rëndësinë e këtij departamenti.</p>

<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Një bashkëpunim të gjerë UK ka edhe me aktorë biznesi brenda vendit, ku marrëveshjet e nënshkruara ju japin përgjegjësi palëve për tu dhënë mundësi studentëve të kryejnë praktika profesionale në këto biznese.</p> <p>Nga vlerësimet e bëra nga departamenti në analizat mësimore-kërkimore dhe nga opinionet e studentëve të programit, ky program ka rezultuar i suksesshëm dhe është vlerësuar: si në tregun e punës ashtu edhe në atë të studimeve të niveleve më të larta siç është ai i studimeve të nivelit të dytë të masterit. Studentë të këtij departamenti kanë rezultuar të suksesshëm edhe në universitetet e huaja ku ata kanë shkuar në kuadrin e shkëmbimeve bilaterale</p> <p>Stafi është mjaft i përkushtuar dhe i orientuar drejt këtij qëllimi, po keshtu qasja e UK me mbështetjen dhe përkushtimin e drejtueses të departamentit, profesoratit dhe deri tek stafi më i ri.</p> <p>Institucionalisht UK ka një numër të madh marrëveshjesh më këto institucione ku palët angazhohen për shkëmbim eksperience dhe ekspertize në funksion të përmirësimit të procesit mësimor dhe realizimit të objektivave të programeve të studimit, përmes identifikimit të kërkesave të tregut dhe mundësisë që studentët të prezantohen direkt me biznesin.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim” synon arsimimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e menaxhimit duke synuar të pajisë studentët me njohuritë themelore në këte fushe nëpërmjet integritit të mësimin me kërkimin. Programi synon të zhvillojë aftësitë, shprehitë dhe kompetencat e studentëve për t’u bërë ekspertë të denjë të fushës së menaxhimit të bizneseve. Institucioni ka vendosur në kohë marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrohen. Për këtë, ekzistojnë shumë marrëveshje të realizuara nga UK me institucione dhe biznese kombëtare dhe ndërkombëtare në funksion të realizimit të praktikave profesionale të studentëve të programeve të ofruara në UK, në FE dhe të programit në veçanti. Nga departamenti është konsideruar, sikurse edhe nga vetë IAL se zhvillimi i praktikës mësimore është një fazë e rëndësishme që lidhet me formimin praktik të studentëve si dhe me mundësi mjaft të mira të tyre për sistemim në punë.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Në funksion të këtij qëllimi, por jo vetëm, institucioni angazhon edhe zyrat mbështetëse si p.sh. zyra e karrierës e cila përmes organizimit të alumni, mbajtjes së marrëdhënieve me studentet përmes përdorimit të gjurmimit të tyre si instrument vlerësues dhe matës sasior, mundohet nga njëra anë të vlerësojë dhe të sigurohet për cilësinë e transmetuar të dijeve dhe përputhjes së tyre me atë cka kërkon tregu, por edhe të përdorë si aset studentet e diplomuar dhe të pozicionuar në drejtime të rëndësishme dhe strategjike të rajonit. Pavarësisht sfidave që kjo zyrë përballat, qënësia e saj, mbështetja që i jepet studenteve aktualë apo atyre të diplomuar, si dhe marrëdhëniet brenda vetë IAL e kanë pozicionuar tashmë si mjaft jetike dhe strategjike për të gjithë IAL.</p> <p>Krahas marrëveshjeve që vendos institucioni përmes së cilave mundëson, mbështet dhe ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit, ky institucion përmes lidhjeve dhe marrëdhënieve që mbart dhe regjistron edhe pas përfundimit të studimeve të studentëve, mundohet të mbështesë studentët sipas profileve të studimit përkatës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim”, është organizuar në module të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin European të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi (L. 80/2015 & VKM Nr. 41 datë 24.01.2018). Departamenti i menaxhimit ka hartuar dhe miratuar Rregulloren e këtij programi studimi Bachelor (Aneksi nr. I.21) dhe bazuar në të ka përgatitur dosjen e plotë të këtij programi. Bazuar në kurrikulën e programit të studimit (Aneksi no. I.24) programi është organizuar në 22 module ku secili modul organizohet në disa lëndë. Secila lëndë vlerësohet me një total të caktuar kreditesh (4 ECTS, 5 ECTS, 6 ECTS dhe 7 ECTS). Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik në këtë program studimi është 60 kredite. Në fund të këtij programi studimi, studenti i ciklit të parë të studimeve duhet të ketë grumbulluar 180 kredite formimi. (Aneksi II.01, I.25)
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Bazuar në Rregulloren e programit të studimit (Aneksi nr.I.21), studimet e ciklit të parë Bachelor në “Menaxhim” synojnë arsimimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e menaxhimit. Ato synojnë sigurimin e njohurive të nevojshme në këtë fushë duke integruar mësimin me kërkimin. Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim” përfshin module ekonomike të cilat iu sigurojnë studentëve një përgatitje të gjerë, një gamë të gjerë të profileve në studimet e mëtejshme, si dhe mundësi që të përshtaten në tregun e punës. Programi i studimit adreson siç duhet nevojat specifike aktuale të tregut të punës duke krijuar në këtë mënyrë studentëve mundësi punësimi jo vetëm në fushën e menaxhimit, por edhe në fusha të tjera.
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim”, ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë formimin e studentëve duke zhvilluar njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale dhe analitike në fushën e menaxhimit, të nevojshme për zgjidhjen e problematikave komplekse në këtë fushë. Ai është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit. Gjithashtu, ky program kujdeset që të pajisë studentët me njohuritë bazë të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit. Duke vlerësuar dosjen e këtij programi studimi si dhe duke u bazuar në konstatimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, mund të konkludojmë se ky program studimi synon që të zhvillojë studentët me njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fushën e studimit të Menaxhimit.
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Objektivi kryesor i programit Bachelor në “Menaxhim” është t’u japë studentëve njohuritë e nevojshme dhe bazë për formimin e tyre si specialistë/administratorë biznesi të njësive ekonomike të vogla e të mesme dhe të sektorit publik si dhe për vazhdimin e studimeve të mëtejshme në fushat e biznesit. Programi studimit jep një sistem bazë njohurish formuese në fushën e ekonomisë, menaxhimit, marketingut, financës dhe kontabilitetit me objektivi kryesor formimin e specialistëve të aftë për të punuar në marketing dhe administrim biznesi dhe për realizimin e studimeve të avancuara në këtë fushë.
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të	Duke u bazuar në dosjen e këtij programi studimi dhe konstatimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, mund të konkludojmë se ky program studimi përmban elementet e nevojshëm që lejojnë krijimin e strukturës së tij (Aneksi I.24).

studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Kurrikula e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim”, hartohet nga departamenti dhe më pas miratohet nga Dekani i FE-s si dhe nga Senati i UK-së. Në fillim të çdo viti akademik, departamenti, bazuar në kurrikulën përkatëse, harton planin mësimor, i cili miratohet nga dekani i FE dhe Rektori. Në planin mësimor pasqyrohen elementet si: emërtimi i moduleve, kurset e ndara në semestra, numri i krediteve për çdo modul dhe raporti i orëve, detyrimet për secilin modul, periudha dhe mënyra e kontrollimit të dijeve për secilin modul, si dhe mënyra e zhvillimit të provimit final për secilin modul (Aneksi I.27, I.21).			
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Ky program studimi ka përcaktuar veprimtaritë formuese duke grupuar modulet në përputhje me kategoritë e përcaktuara në VKM nr.41 dt. 24/01/2018 (Pika 2.5) dhe ka përcaktuar gjithashtu edhe ngarkesën përkatëse në kredite për secilën kategori të veprimtarive formuese brenda këtij programi studimit duke respektuar peshën e përcaktuar në VKM nr.41 dt. 24/01/2018. Më poshtë paraqitet situata e klasifikimit të lëndëve në këtë program studimi: Lëndë bazë (përgatitja metodologjike dhe kultura e përgjithshme) – 6 module (19%) Lëndë karakterizuese, (formim specifik) – 19 module (53%) Lëndë ndërdisiplinore (nëndisiplina, profile grup-lëndë me zgjedhje) – 6 module (15%) Lëndë plotësuese (gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale) – 5 module (9%) Detyrime përmblylëse (përgatitja e tezës së diplomës) – (4%) Ky programi i jep një peshë të rëndësishme praktikës profesionale dhe punimit të diplomës, pra punës kërkimore të realizuar nga studenti. Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim” është i organizuar me 180 kredite formimi dhe ka një kohëzgjatje 3 vite akademike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.2**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Sipas ligjit në fuqi (L. 80/2015, Neni 22, pika 1) IAL-të duhet të përbëhen nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera të përcaktuara në statutin e tyre. Në përputhje me ligjin në fuqi (L. 80/2015, Neni 22, pika 2), njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimeve Bachelor në “Menaxhim”, është Fakulteti i Ekonomisë (FE). Kjo njësi kryesore përbëhet nga 3 Departamente (njësi bazë) në përputhje të plotë me detyrimet ligjore në fuqi. 1. Departamenti i Menaxhimit; 2. Departamenti i Financë - Kontabilitet; 3. Departamenti i Marketinut dhe Turizmit Në përputhje me ligjin në fuqi (L. 80/2015 - Neni 22, pika 3, Neni 25, pika 1) njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, është Departamenti i Menaxhimit. Personeli i departamentit përbëhet nga personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik (L. 80/2015 - Neni 57, pika 1). Aktualisht departamenti i Menaxhimit ka 10 pedagogë efektivë nga të cilët: 4 profesorë të asociuar, 4 doktor shkencash, 1 student doktore dhe 1 Msc. Kualifikimi dhe përgatitja e stafit është në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë. Stafi akademik ka mesatarisht mbi 16 vjet përvojë pedagogjike dhe moshë mesatare 45 vjeç. Departamenti, gjithashtu angazhon pedagogë me kohë të pjesshme me eksperiencë pune, si edhe me kualifikimin e nevojshëm. Stafi akademik i departamentit është i

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	angazhuar në një punë të gjerë studimore-shkencore e botuese në funksion të procesit mësimor. (https://www.unkorce.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomis%C3%AB) (Aneksi I.31, I.42)			
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p> <p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Njësia kryesore e këtij programi, Fakulteti i Ekonomisë, bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta dhe të ndërthurura njëra me tjetrën (L. 80/2015, Neni 23, pika 1). Ai ofron programe studimore të nivele të ndryshme, ku në përfundimin e të cilave i pajisë studentët me diplomë të cikleve të ndryshme. (Aneksi I.27)</p> <p>FE ofron programe studimi në cikle të ndryshme studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Program dy vjeçar, me karakter profesional pas arsimit të mesëm, “Asistent Menaxher” hapur me VKM nr. 370, datë 05/07/2018. - Programi i studimit Bachelor në "Menaxhim", hapur me VKM nr. 230, datë 29/05/1992, Pika 2 (c). - Programi i studimit “Bachelor” në "Informatikë biznesi" hapur me VKM nr. 402, datë 12/07/2018. - Programi i studimit “Master Profesional” në “Administrim biznesi”, hapur me VKM nr. 565, datë 23/11/2011 dhe riorganizuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 575 datë 01/10/2018. <p>Koordinatori i programit të studimit Bachelor në "Menaxhim" (Aneksi II.09), luan një rol të rëndësishëm dhe aktiv në drejtim të zhvillimit dhe rritjes të cilësisë të programit të studimit. Detyrat e Koordinatorit të programit janë të përcaktuara në Rregulloren e Departamentit të Menaxhimit, Kreu II, Neni 9 (Aneksi I.42).</p> <p>Midis Koordinatorit të programit dhe drejtuesit të Departamentit ekziston një bashkëpunim i vazhdueshëm, në ndihmë të vendimmarrjes për ecurinë dhe zhvillimin e programit.</p> <p>Siç përmendet edhe më sipër në kriterin nr.1, ky fakultet është i organizuar në 3 njësi bazë për zhvillimin e mësimin dhe punës kërkimore-shkencor. Organizimi dhe funksionimi i këtyre njësive bazë parashikohet në statutin e UK-së, Rregullores së FE dhe Rregulloreve të njësive bazë. (Aneksi I.01, I.27)</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, është i kualifikuar dhe i aftë për të përmbushur detyrimet e këtij programi studimi në përputhje me ligjin në fuqi (L. 80/2015 - Neni 59, pika 6).</p> <p>Bazuar në të dhënat përkatëse, rezulton se personeli akademik ka kualifikimet e mëposhtme:</p> <p>Profesor të asocuar – 4 Doktor – 4 Student Doktorature - 1 Master – 1 (Aneksi I.31)</p> <p>Në bazë të nevojave vjetore, departamenti përveç personelit akademik të brendshëm, angazhon edhe personel të jashtëm akademik. Planifikimi për stafin akademik të ftuar (PAK) bëhet në fillim të çdo viti akademik dhe miratohet nga Dekanati dhe nga Rektorati. Bazuar në dokumentin që pasqyron ngarkesën mësimore të personelit akademik të përfshirë në programin e studimit, konkludojmë se ngarkesa mësimore për 2 vitet e fundit është mbuluar pothuajse plotësisht nga personeli akademik i brendshëm i departamentit. (Aneksi I.31, Vizita në IAL).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p> <p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p> <p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për organizimin e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim”, disponon dokumentacionin e plotë për këtë program studimi ku përfshihen: Kurrikulat e programit të studimit për periudhën 2016-2019 dhe 2017-2020 (Aneksi I.24); Plani mësimor (Aneksi II.01); Klasifikimi i lëndëve sipas përcaktimeve ligjore në fuqi (Aneksi II.02) si dhe Syllabuset e lëndëve. Kurrikula e këtij programi studimi është ndërtuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi (VKM nr.41 dt. 24/01/2018). Në të pasqyrohen objektiva formues dhe kompetenca profesionale përcaktuese dhe specifike që duhet të ofrojë një program studimi Bachelor në “Menaxhim” (Aneksi I.42).</p> <p>Kurrikula është e organizua në 22 veprimtari formuese, bazë, karakterizuese, plotësuese dhe përmbyllëse si tema e diplomës. (sipas planit mësimor Aneksi II.01)</p> <p>Në vitin e parë studentët zhvillojnë 7 module të organizuara në 11 lëndë. Në vitin e dytë studentët zhvillojnë 7 module të tjera të organizuara në 13 lëndë. Në vitin e tretë studentët zhvillojnë 6 module të organizuara në 10 lëndë. Gjithashtu vitin e tretë studentët realizojnë praktikën mësimore si dhe temën finale të diplomës. Në përfundim të çdo viti studenti mer 60 kredite për një total prej 180 kreditesh në përfundim të studimeve.</p> <p>Objektivat formues dhe kompetencat profesionale përcaktuese i gjejmë të pasqyruara në modulet e semestrit të parë dhe të dytë, ndërsa kompetencat profesionale specifike i gjejmë të pasqyruara në modulet që zhvillohen në semestrat në vazhdim. Semestri i gjashtë përfshin praktikën profesionale dhe zhvillimin e temës së diplomës që finalizon këtë cikël studimi. (Aneksi II.01, I.24, II.02, https://www.unkorce.edu.al/sq/programet-e-studimit-bachelor)</p> <p>Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në “Menaxhim”, plani mësimor buron nga kurrikula e këtij programi studimi dhe pasqyron periudhën kohore përgjatë së cilës zhvillohet secili modul i këtij programi.</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit përbën dokumentacionin kryesor me karakter të gjerë informativ. Ai hartohet nga Përgjegjësi i Departamentit (Njësia Bazë) dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i UK.</p> <p>Plani mësimor përfshin elementet e mëposhtëm në përputhje me VKM nr.41 dt. 24/01/2018 (Pika 2.6):</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emërtimin për secilin modul të këtij programi studimi për çdo kurs, të grupuara dhe të renditura sipas semestrave përkatës; 2. Numrin e krediteve për çdo modul (siç është përmendur edhe më sipër, kreditet për modul variojnë nga 3 - 7 ECTS) 3. Orët në total për secilin modul (në varësi të llojit të lëndës, variojnë nga 30-75 orë) dhe raporti i orëve - leksion/seminar (në varësi të llojit të lëndës, varion në 0:2, 1:2, 2:1, 2:2 dhe 3:2, kryeson raporti 2:1 dhe 2:2); 4. Detyrimet për secilin modul (seminare, ushtrime, projekte kursi, detyra kursi, detyra kontrolli); 5. Raporti i vlerësimit të studentit (në varësi të llojit të lëndës, varion nga 20- 40% gjatë vitit në 60-80 % provimi përfundimtar) 6. Periudha (në varësi të semestrit që zhvillohet 1,2,3,4,5 &6) dhe mënyra e kontrollit të dijeve për çdo modul (provim ose kolokium – rezulton provim për të gjitha lëndët); 7. Mënyra e zhvillimit të provimit final për çdo modul (provim me gojë, me shkrim, me gojë & me shkrim). (Aneksi II.01)

<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në Rregulloren e departamentit dhe të programit të studimit pasqyrohen qartë të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në përputhje me ligjin në fuqi (L. 80/2015, Neni 76, 89, VKM, 2.7 kuotat e pranimit).</p> <p>Kriteret e pranimit të studentëve në programet e ciklit të parë të studime në Departamentin e menaxhimit përcaktohen nga MASR (udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i Ministrave apo MASR për vitin akademik përkatës), statuti dhe rregullorja e studimeve të FE-së dhe UK-së (Aneksi I.27, I.02).</p> <p>Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë bëhet i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional si dhe kandidatët që disponojnë diplomë të shkollës së mesme jashtë vendit (pasi realizohet ekuivalentimi i diplomës së fituar në vendin e huaj nga komisioni përkatës në MAS); të cilët plotësojnë kriteret si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Kriterin e meritës (mesatare e shkollës së mesme) e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. ○ Kriterin e rëndësisë (koeficienti i përcaktuar për shkollën nga vjen, sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit). ○ Nota mesatare e lëndës me zgjedhje në fushën e ekonomisë. ○ Kuota të paracaktuara 			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Modeli i programit të lëndës që përdoret për hartimin e syllabuse-ve, në programin e studimit Bachelor në “Menaxhim”, është modeli i përcaktuar në VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 (Pika 2.8, shtojca no.2).</p> <p>Në përgjithësi syllabuset e lëndëve të këtij program studimi respektojnë elementet përbërës të modelit sipas përcaktimeve VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 (Shtojca no.2). (Aneksi I.25)</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik pedagogu i lëndës i njej studentët me komponentët kryesorë të saj se dhe me detyrimet dhe përgjegjësitë përgjatë zhvillimit të asaj lënde. Programet lëndore vihen në dispozicion edhe nëpërmjet sistemt ESSE3. (Vizita në IAL)</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Nëse i referohemi kurrikulës së programit si dhe takimeve të realizuara vëmë re se ky program studimi është në vazhdimësi i hapur drejt ndryshimeve të mundshme. Këto ndryshime kanë si qëllim përmirësimin e programit në përputhje me kërkesat e tregut dhe duke marrë parasysh zhvillimet e fundit. (Vizita në IAL, Aneksi II.11).</p> <p>Nga takimi i realizuar me personelin akademik që japin mësim në këtë program studimi u informuam se çdo fillim viti, por edhe gjatë vitit, diskutohet dhe bëhen përditësime apo rifreskime në programet e lëndëve duke përfshirë në to informacione mbi zhvillimet më të fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit, vlen të përmendim këtu vendosjen në dispozicion të studentëve të rasteve të studimit më të fundit. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se këto ndryshime, sidomos referuar pjesës praktike të realizuar gjatë seminarit, duhet të pasqyrohen edhe në syllabus.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesa mësimore javore në auditor për programin e studimit Bachelor në "Menaxhim" është në përputhje me parashikimet nënligjore në fuqi (VKM nr. 41, Dt.24.01.2018, Pika 2.1.d). Program i studimit realizohet me 180 kredite dhe me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, e shtrirë në 6 semestra, ku secili semestër ka 15 javë mësimore. Ngarkesa mësimore javore në auditor në lidhje me leksione, seminare, ushtrime, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe praktika të zhvilluara në auditor, është jo më shumë se 25 orë mësimore. (Aneksi I.24, II.05)</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive formuese të këtij programi studimi mundësojnë thellimin dhe aftësimin e studentëve në fushën e menaxhimit të biznesit duke i dhënë atyre mundësi të mira punësimi në këtë fushë. Në takimin e realizuar me studentët e këtij programi, mësuam se orët e mësimin në auditor (leksione, seminare, ushtrime apo praktika në laboratorë) zhvillohen në formë interaktive ndërmjet pedagogut dhe studentit, ku pedagogët paraqesin shembuj të ndryshëm për të mbështetur pjesën teorike dhe raste studimi të ndryshme për të stimuluar mendimit krijues dhe kritik të studentit.</p> <p>Në planin mësimor të këtij programi studimi, për secilën lëndë, gjejmë të pasqyruara shpërndarjen e orëve për leksione dhe seminare në auditor. Në disa lëndë të caktuara, gjatë seminarit mund të aplikohen raste studimi, detyra apo projekte kursi për të zhvilluar aftësitë komunikuese të studentëve si dhe për t'i nxitur ata të përvetësojnë procesin e kërkimit.</p> <p>Ndarja e lëndëve me karakter formues ndaj atyre aplikative krijon mundësinë për të fituar njohuritë teorike gjatë dy semestrave të parë dhe mundëson aftësimin gradual praktik në semestrat që vijojnë. Studenti, në 15 javë mësimore në auditor, gjatë leksioneve (2 orë në javë) merr njohuritë e duhura rreth çështjeve apo tematikave të caktuara për secilin modul. Gjatë seminareve studentët analizojë çështjet e leksionit, si dhe punojnë në mënyrë të pavarur apo në grup raste studimore në funksion të temave të lëndëve. Nga takimi i realizuar me studentët kuptuam se rastet e studimit që analizoheshin në klasë janë në përputhje me temat e mësimin dhe prekin çështje që kanë interes të veçantë në ditët e sotme. Ndërsa nga takimi i realizuar me pedagogët mësuam se realizimi i detyrës së kursit i aftëson studentët për të punuar në grup, për të ndarë punën, për të komunikuar në mënyrë elokvente, gjithashtu i mëson sesi duhet të mbledhin dhe të analizojnë informacion për çështje të caktuara. Edhe nga takimi i realizuar me studentët vërtetuam këtë aspekt të rëndësishëm të detyrave të kursit.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit Bachelor në "Menaxhim" (Aneksi I.24) është hartuar në përputhje me profilin e programit dhe nevojat e specialitetit. Lëndët/modulet reflektojnë emërtimin e programit dhe i shërbejnë formimit të nevojshëm profesional. Kurrikula përfaqëson me programet e ngjashme ndërkombëtare. Në programin e studimit Bachelor në "Menaxhim" shpërndarja e moduleve sipas kategorive të veprimtarisë formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik janë në përputhje të plotë me VKM Nr. 41, Shtojca 1, Tabela I dhe Pika 2.1 (Aneksi II.02).</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e këtij programi studimi, duke përfshirë natyrën e moduleve të ofruara, ngarkesën e tyre në ECTS, raportin e aspekteve teorike dhe aplikimeve të mundshme praktike, është në përputhje me profilin e këtij programi bachelor. Natyra e moduleve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike të informacionit që jep një modul dhe aplikimeve të mundshme praktike. Gjithashtu, për specifikën që paraqet, tenton të mbulojë nevojat në tregun e punës në rajon. (Aneksi I.25)</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues,</p>	<p>Sic shpjegohet edhe në standartin II.1, kriteri 6, shpërndarja e lëndëve në përputhje me VKM 41 është si më poshtë:</p> <p>Lëndë bazë (përgatitja metodologjike dhe kultura e përgjithshme) – 6 module (19%) Lëndë karakterizuese, (formim specifik) – 19 module (53%)</p>

transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Lëndë ndërdisiplinore (nëndisiplina, profile grup-lëndë me zgjedhje) – 6 module (15%) Lëndë plotësuese (gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale) – 5 module (9%) Detyrime përmblylëse (përgatitja e tezës së diplomës) – (4%) (Aneksi II.04)								
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Nga bisedat e realizuara me grupin e vlerësimit të brendshëm dhe pedagogët që japin mësim në këtë program studimi, del në pah se departamenti analizon ecurinë e çdo programi studimi duke përfshirë në to mendimin dhe opinionin e të gjithë personelit akademik. Pedagogët pohuan se çdo fillim viti, por edhe gjatë vitit, diskutohet dhe bëhet përditësimi apo rrifreskim i syllabuseve duke u kujdesur për të përfshirë në to informacione mbi zhvillimet më të fundit të shkencës. Në kuadër të përmirësimit të programeve të moduleve, një feedback vjen edhe nga rezultatet e anketës që realizohet me studentët, ku ata japin mendimin e tyre si për pedagogët dhe për lëndët përkatëse të tyre. Nëse i referohemi shqyrtimit të syllabuseve të këtij programi studimi, për një pjesë të mirë të tyre (Aneksi I.25) rezulton se literatura, qoftë bazë apo ndihmëse, është relativisht e mjaftueshme dhe e përditësuar. Megjithatë vlen të përmendet se ka ende vend për përmirësim dhe përfshirje të elementeve që lejojnë evidentimin e literaturës së përditësuar në module të caktuara.								
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim dhe dijeve, aftësi dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim”, ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë formimin e studentëve duke zhvilluar njohuri, aftësi, si dhe kompetenca profesionale dhe analitike në fushën e biznesit, të nevojshme për zgjidhjen e problematikave komplekse në këtë fushë. Fokusi i studimit të programit Bachelor është marrja e njohurive bazë mbi metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme, por dhe për formimin e shprehive të veçanta në fushën e menaxhimit të biznesit, marketingut të produkteve të ndryshme si dhe në atë të menaxhimit. Studentët fitojnë: njohuri dhe kompetenca në menaxhimin dhe zhvillimin e sistemit të biznesit; njohuri mbi funksionet e marketingut, strukturat e tregut dhe institucionet e marketingut të produkteve; njohuri në menaxhimin e burimeve njerëzore, zotërimin e njohurive mbi modelet e organizimit të biznesit, dhe njohjes së rolit të menaxhimit në suksesin e një biznesi; etj.								
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunësorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Programi i studimit i ciklit të parë, Bachelor në “Menaxhim” kujdeset që të pajisë studentët me njohuritë bazë të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të studimit si Master Profesional apo Master Shkencor. Kurrikula është zhvilluar dhe ristrukturuar duke u bazuar kryesisht në eksperiencën e universiteteve amerikane dhe europiane, e sjellë kjo nga projekte të ndryshme bashkëpunimi. Megjithatë, zhvillimet e reja në tregje kanë bërë të nevojshme përshtatjen e këtyre kurrikulave. Për rrjedhojë në kryerjen e ndryshimeve në kurrikula apo në përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit, përfshirë këtu edhe programin në fjalë, departamenti kryen në vazhdimësi studime tregu për të identifikuar nevojat që ka biznesi për ekspertë në fushën e menaxhimit të biznesit. Nga biseda e realizuar me Përgjegjësen e Departamentit, mësuam se këto studime janë kthyer në një praktikë të mirë të departamentit dhe ndihmojnë në vazhdimësi përmirësimin e mundshëm të kurrikulave. (Aneksi I.22, Vizita në IAL)								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.5

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Personeli i programit të studimit për vitin akademik 2019-2020, përbehet nga 28 staf akademik nga ku 27 PAE dhe 1 PAK. Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në “Menaxhim” me kohë të plotë dhe më kohë të pjesëshme përmbush të gjitha kërkesat ligjore në fuqi. I gjithë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi mban gradën professor, Doctor dhe kualifikimin Msc, një gradë më lartë sesa cikli i studimit ku japin mësim (L. 80/2015 - Neni 59, pika 6).</p> <p>Për realizimin e programit të studimit, të angazhuar janë personel akademik me kohë të plotë në masën 96% dhe personel me kohë të pjesëshme në masën 4%. Ngarkesa mësimore në orë e stafit akademik të programit të studimit varion nga minimum 120 orë deri në 401 orë. Sipas të dhënave të mara në IAL, 86% e stafit akademik të angazhuar në këtë program zotëron tituj dhe grada shkencore, <i>mirëpo ajo që vihet re është se jo të gjithë titullarët e lëndëve i përkasin kategorisë Profesor, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.</i> Dosjet e plota të stafit akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar janë të plota dhe të depozituara pranë zyrës së burimeve njerëzore.</p> <p>(Vizita në IAL, Aneks I.29, I.33)</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Fusha akademike-kërkimore e anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve ku japin mësim. Anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë (PAE) kanë të gjitha kualifikimet dhe kompetencën për të zhvilluar me cilësi të lartë programin e lëndës. Nga shqyrtimi i CV-ve të personelit akademik të këtij programi del në pah se orientimi i studimeve master, doktoraturë, apo kërkimor i stafit përkon me ekspertizën në fushat që ata mbulojnë në kurrikulën e programit të studimit dhe me natyrën e moduleve që mbulojnë në këtë program studimi.</p> <p>(Aneks II.17, Vizita në IAL)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Duke iu referuar kurrikulës së programit të studimit rezultoi se studentët gjatë semestrit të 6-të zhvillojnë praktikën profesionale dhe paralelisht përgatisin temën e diplomës. (Aneksi II.01).</p> <p>Natyrë e këtij programi studimi kërkon kryerjen e praktikës profesionale pranë kompanive të ndryshme, kryesisht të fushës së biznesit. Për realizimin e praktikës profesionale Institucioni ka përcaktuar në rregullore udhëzimet përkatëse (Aneks II.15). Për t’i dhënë mundësi studentëve për të kryer praktikën profesionale, Qendra e Karrierës dhe Alumni, përgjatë panairëve të karrierës që ka organizuar në UK, ka nënshkruar shumë marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës (sipërmarrje, institucione publike, OJF). (Aneks I.35, I.36)</p> <p>Pavarësisht vështirësive që mbart procesi i praktikave profesionale, Institucioni mundohet të ketë një bashkëpunim sa më të mirë me aktorët e tregut të punës. Megjithatë, duke iu referuar edhe diskutimit me studentët e këtij programi ende ka vend për përmirësime në kuadër të praktikave profesionale.</p> <p>Gjatë periudhës së praktikës profesionale, studentët punojnë paralelisht për të zhvilluar punimin e diplomës. Sipas takimeve të realizuara në IAL u konstatua se të gjithë studentët përfundojnë studimet e tyre duke mbrojtur një temë diplome. <i>Grupi i Vlerësimit të jashtëm sygjeron që të vendoset një kriter note mesatare për studentët që realizojnë temë diplome, duke bërë kështu që studentët më të mirë të kenë mundësi për zhvillimin e një teme. Kjo do të rriste dhe cilësinë e punimeve të diplomës.</i></p>

	Gjatë kësaj peirudhe kohore studenti supervizohet nga pedagogu udhëheqës në procesin e mbledhjes së të dhënave, përpunimit dhe analizës së tyre si dhe në shkrimin e finalizimin e materialit të diplomës. (Aneksi II.15, I.40, II.16)			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Studentët e këtij programi studimi kryejnë praktikala laboratorike përkatësisht në lëndët: “Informatikë”, “Kontabilitet”. Gjatë këtyre orëve, krahas pedagogut të lëndës asistojnë edhe stafi ndihmës akademik që janë përgjegjës për këto laboratorë duke dhënë ndihmën e tyre në realizimin dhe mbështetjen e orës laboratorike. <i>Grupi i Vlerësimi të jashtëm sygjeron që të rriten përpjekjet e stafit pedagogjik në mënyrë që të realizohen edhe module të tjera me praktika laboratorike, si Statistikë.</i> Nga vizita e realizuar në ambjentet e FE, rezulton se janë në funksion të studentëve disa laboratorë informatike, të cilët përdoren për kryerjen e praktikave laboratorike në lëndë të caktuara. Këta laboratorë janë të pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme për realizimin e këtyre praktikave. (Vizita në IAL)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve. Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të	Pasi u vlerësuan dokumentacionet e vendosura nga UK (Aneksi I.02 – rregullorja e UK) dhe FE (Aneksi I.27 – Rregullorja e brendshme e FE), faqja e UK, si edhe pas komunikimit me zyrën e kurrikulave, rezulton se ky institucion përkrah aplikimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit. Faqja e internetit ka seksion të dedikuar mbi proceset online duke treguar përpjekjet e institucionit për përdorimin e metodave inovative, gjë që përmirëson më shumë procesin e nxënies dhe i bën studentët më pjesëmarrës dhe krijues në procesin mësimor. GVJ pas takimit me përgjegjësen e departamentit, Dekanen dhe me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë (KSCK), si edhe pas shqyrtimit të dokumentacionit (Aneksi I.27; Aneksi III.01), rezulton se ato zhvillojnë mekanizma monitorimi të vazhdueshme të cilësisë së mësimdhënies në të gjithë elementët e saj si leksione, seminare, punëve laboratorike dhe praktikën profesionale. Këto mekanizma fokusohen kryesisht në: <ul style="list-style-type: none">Vlerësimin e mësimdhënies në auditor, për personelin akademik (lektor dhe asistentë lektor) nga përgjegjësja e departamentit.

<p>vlerësimi të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p> <p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimin nëpërmjet sondazhit, ku tërhiqet mendimi dhe opinion i studentëve për performancën akademike të stafit mësimdhënës. • Vlerësimi nga KSCK, në bazë të përgjigjeve të studentëve <p>Referuar RVB-së dhe nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion, rezultojnë se studentët para përfundimit të çdo semestri përfshihen në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Përveç kontrollit periodik të realizuar nga përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me KSCK, për mënyrën e zhvillimit të leksioneve duke asistuar në leksion dhe më pas duke diskutuar konkluzionet me pedagogun dhe studentët e grupit, KSCK organizon një anketim çdo semester dhe për çdo lëndë për të vlerësuar performancën e lektorëve në mësimdhënie.</p> <p>Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie janë Drejtoria e KSCK (nivel institucional), Njësia për Sigurimin e Cilësisë (nivel njësie) dhe Përgjegjësi i Departamentit (njësia bazë).</p> <p>Rezultatet nga KSCK diskutohen në Senat dhe komentet i dërgohen Dekanit, ndërkohë që Përgjegjësi i Departamentit i diskuton në mbledhjen e departamentit me stafin akademik (Aneksi III.02).</p> <p>Nga diskutimet me pedagogët e programit shikohet që nga të dhënat e përfuara nga vlerësimet periodike janë marrë masa për nxitjen, rritjen dhe përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies duke shtyrë diskutimin mbi për mënyrën e zhvillimit të leksioneve dhe përmirësimin e infrastrukturës.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="555 871 751 931">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="751 871 963 931">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="963 871 1171 931">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1171 871 1461 931">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="555 931 751 972"></td> <td data-bbox="751 931 963 972"></td> <td data-bbox="963 931 1171 972"></td> <td data-bbox="1171 931 1461 972" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p> <p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave</p>	<p>Bazuar në RVB, Planit mësimor (Aneksi II.01), Programeve lëndore (Aneksi, I.25/2019-2020; 2018-2019; 2017-2018), takimeve me përgjegjësen e Departamentit, Dekanen, Stafin akademik dhe studenteve, u konstatua se në këtë program përdoren forma alternative si leksione, seminare, punë laboratorike, detyra kursi, projekte kursi, provime të ndërmjetme dhe përfunimtare, praktika mësimore dhe profesionale. GVJ konstatoi, se ka përputhshmëri mes specifikimeve të rregullores dhe përcaktimeve të këtyre formave në syllabus dhe në aplikim.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në "Menaxhim" ofrohet i organizuar në lëndë e module dhe vlerësuar në kredite në përputhje me: Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, neni 70, pika (1); Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore të UK, neni 56, pika (1).</p> <p>Programi i studimit ofrohet i vlerësuar me kredite në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS) ku, orët/kreditet e këtij cikli studimesh janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 180 ECTS në 3 vite (60 ECTS për çdo vit) • Kohëzgjatja e programit të studimit është 3 vite akademike, e shtrirë në 6 semestra. Çdo semestër ka 15 javë mësimore. • Orët mësimore në auditor janë: viti i parë 645 orë, viti i dytë 750 orë dhe viti i tretë 646 orë. • Ngarkesa minimale javore 20-25 orë. <p>Gjithashtu, stafi akademik i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke përshtatur dhe ofruar mundësi dhe forma alternative të mësimdhënies, mësimnxënies</p>

<p>didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p> <p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>dhe të kontrollit të dijes. Nga bashkëbisedimi me studentët u konstatua se përveç leksioneve, gjatë seminareve krahas kontrollit të njohurive nëpërmjet pyetjeve/përgjigjeve dhe diskutimeve, aplikohen edhe raste studimore e detyrat individuale me studentët. Natyra specifike e këtij program studimi kërkon përdorimin dhe aplikimin e metodave të larmishme të mësimdhënies nëpërmjet kompjuterave dhe sistemit të rrjeteve të internetit.</p> <p>Nga vizita në institucion rezulton se Fakulteti i Ekonomisë në UK, me synimin e përmirësimit të kompetencave didaktike, të metodologjive të mësimdhënies, ka investuar në teknologji si dhe ka zhvilluar leksione të hapura, seminare dhe ëorkshope si në kuadër universiteti ashtu edhe në kuadër të sektorit të turizmit.</p> <p>Gjithashtu, UK dhe departamenti kanë marrëveshje me universitete të tjera partnere perëndimore dhe rajonale, ku stafi akademik ka mundësi të përfitojë nga programet e shkëmbimit (Aneksi I.35; Aneksi I.36).</p> <p>Nga informacioni i siguruar nga studentët, gjatë vizitës në institucion si dhe referuar CV-ve (Aneksi II.10), fushave të ekspertizës dhe eksperiencës së stafit, rezulton se stafi akademik është kompetent në shpjegimin e koncepteve dhe transmetimin e njohurive, nëpërmjet përdorimit të metodave të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit përkatës.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 11 pedagogë të kategorisë Prof. Asoc. • 13 pedagogë me gradën Dr. • 4 pedagogë me gradën Msc. <p>Personeli akademik përdor me kompetencë pajisjet në dispozicion të mësimdhënies si dhe ka pajisur studentët me tekste dhe cikël leksionesh.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p> <p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p> <p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Institucioni periodikisht vlerëson format dhe metodat e mësimdhënies, me qëllim përmirësimin e këtyre metodave në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, duke përfshirë edhe studentët. Studentet i shprehin shqetësimet dhe sugjerimet e tyre nëpërmjet këshilltarit akademik ose pranë sekretarisë ndaj studentëve, të cilat i përcillen drejtuesve të njësisë bazë dhe asaj kryesore, apo edhe me lart sipas problematikes së paraqitur.</p> <p>Në funksion të përmirësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies përdoren edhe rezultatet e marra nga pyetësorët e studentëve.</p> <p>Për t'i bërë orët e mësimit sa më konkrete dhe tërheqëse, stafi akademik i brendshëm dhe i jashtëm i Departamentit, i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, përdor metoda interaktive dhe diskutimi me studentët duke i dhënë më shumë mundësi pjesëmarrjes në diskutime.</p> <p>Diskusimet e rasteve studimore, puna në grupe dhe prezantimet e punëve studimore të studentëve, janë disa prej mjeteve kryesore të nxitjes së debateve dhe mendimit kritik që garantojnë ndërveprimin dhe pjesëmarrjen e studentëve në mënyrë aktive në procesin mësimor.</p> <p>Nga informacioni i siguruar në takimin me studentët, gjatë vizitës në institucion, u konstatua se metodat e mësimdhënies të përdorura nga pedagogët inkurajojnë autonomi tek studentët dhe sigurojnë marrëdhënie respekti të ndërsjellë. Studentët inkurajohen të ndërmarrin iniciativa në përzgjedhjen e detyrave të kursit të cilat zhvillohen në grup, gjë që i jep mundësi çdo studentit të shprehë idetë e veta dhe të rrisë shkallen e bashkepunimit në grup. Bashkëpunimi midis studentëve dhe pedagogëve realizohet si gjatë orëve të procesit mësimor ashtu edhe në orët e konsultimeve, të cilat janë të programuara në dite dhe orë të përcaktuara për çdo program studimi.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p> <p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p> <p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p> <p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p> <p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p> <p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p> <p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për</p>	<p>Referuar RVB, Aneksit III.04 dhe vizitës në institucion, rezulton se procesi mësimor dhe shkencor në UK realizohet në hapësira të mjaftueshme të pajisura me mjete dhe pajisje didaktike. GVJ gjatë vizitës në institucion, konstatoi se sallat e leksioneve/seminareve dhe laboratorëve, janë të mjaftueshme dhe procesi mësimor për programin, zhvillohet në godinën e Fakultetit të Ekonomisë.</p> <p>Godinat janë të pajisura me zyra, mjedise shërbimi, mjedise për aktivitete të ndryshme, hapsira rekreative si dhe nyje hidrosanitare. Të gjitha mjediset janë të pajisura me sistem ngrohjeje.</p> <p>Sallat në dispozicion të procesit mësimor të programit, disponojnë infrastrukturë dhe logjistikë të nevojshme për të zhvilluar leksionet me grupe me maksimumi 35 studentë. Ambientet janë të mjaftueshme për të zhvilluar në mënyrë efektive procesin mësimor. Të gjithë auditorët janë të pajisur me poste ulje, tavolina dhe disa pre tyre kanë lidhje interneti, kompjutera, videoprojektor etj. Në të gjitha mjediset e punës funksionon sistemi i ngrohjes.</p> <p>Marrëveshja me RASH (Aneksi III.05), lejon aksesin në U-Library, Moodle, eduMeet, Office 365, ProfilVirtual, për të garantuar nevojat e zhvillimit të leksioneve dhe seminareve online.</p> <p>GVJ, nga takimet me stafin akademik, drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë si dhe referuar syllabuseve të lëndëve (Aneksi, I.25/2019-2020; 2018-2019; 2017-2018), konstaton se për çdo lëndë programit, literatura bazë ofrohet në gjuhën Shqipe dhe përfshin tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt. etj. Tekstet bazë Një pjesë të literaturës studentët i gjejnë fizikisht në bibliotekën e fakultetit, në gjuhën Shqipe dhe në gjuhën Angleze apo në gjuhe të tjera të komunitetit europian.</p> <p>GVJ është e mendimit se biblioteka e institucionit disponon mjaftueshëm literature në gjuhën shqipe dhe të huaj dhe pasurohet vazhdimisht duke reflektuar ndryshimet e programit të studimit.</p> <p>Mjediset e bibliotekave kanë hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët dhe pedagogët dhe janë në dispozicion të tyre nga ora 8.00 deri në 16.00.</p> <p>Gjithashtu, në funksion të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies personeli akademik dhe studentët mund të aksesojnë libraritë on-line nga mjediset e laboratorëve, të pajisur me PC.</p> <p>Studentët dhe stafi i UK-se ka akses në Bibliotekën Dixhitale U-Library nga RASH (https://ulibrary.rash.al/), që mundëson akses në EBSCO Publishing Databases.</p> <p>GVJ vizitoi edhe dy laboratorët e (i) kompjuterizimit financiar (30 kompjutera me programet bazë dhe specifike të kontabilitetit si Alfa) dhe (ii) Hoteleri-Turizmit.</p> <p>Institucioni disponon infrastrukturën e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme referuar programit.</p>

<p>realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p> <p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p> <p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p> <p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Institucioni ka krijuar një ambient virtual të përshtatshëm për të lejuar mësimin online. LMS i UK mund të aksesohet nga adresa http://unkorce.edu.al/sq/lms. Në këtë seksion gjehen udhëzimet dhe lidhjet për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Google Classroom • Google Meet • eduMeet • Moodle <p>Personeli akademik dhe studentët e UK-së, përdorin sistemin informatik që disponon UK dhe kanë hapësirat e veta siç është emaili individual, dhe sistemin ESSE3 me akses të dedikuar.</p> <p>Procesi i zgjedhjes, realizmit dhe mbrojtjes së diplomës, është i rregulluar me rregulloren mbi përgatitjen e diplomave (Aneksi II.04), ku parashikohet që studenti ka të drejtë të zgjedhë temën e diplomës, e cila konsultohet më pas me drejtuesin e punimit.</p> <p>Temat parashtrihen nga titullarët e lëndëve, me miratimin e përgjegjësit të Departamentit. Pas dhënies së preferencave të studentëve Departamenti shpall shpërndarjet e studentëve me pedagogët udhëheqës.</p> <p>Pedagogu udhëheqës gjatë gjithë kohës asiston në zhvillimin e temës duke komunikuar në forma të ndryshme me studentin. Në fund pasi e rishikon punimin ai jep miratimin për mbrojtjen e temës së diplomës duke e nënshkruar atë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në RVB, vizitës në institucion, takimit me KSCK, GVJ konkludon se UK ka ngritur struktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Këto struktura në funksion të procesit mësimor-kërkimor, të përcaktuara sipas standardet shtetërore të cilësisë si dhe standardet dhe udhëzimet europiane për Sigurimin e Cilësisë në HEAL (Aneksi I.01- Statuti i UK, Kreu IX, Neni 73), funksionojnë si një sistem që përbëhet nga: KSCK (Aneksi I.05), departamenti dhe fakulteti. Këto njësi bëjnë përhapjen dhe promovimin e eksperiencave të përparuar në mësimdhënie dhe mësimnxënie.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>GVJ konstatoi se njësia kryesore dhe ajo bazë nxisin dhe mbështesin proceset, të cilat synojnë rritjen e vetëdijes për rëndësinë e cilësisë së programit të studimit. Njësia bazë inician procese për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet tërheqjes së mendimit të studentëve dhe diskutimeve, pothuajse për të gjitha lëndet dhe disa herë gjatë semestrit.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Rezultoni se strukturat dhe njësitë përgjegjëse pranë UK-së, i krijojnë mundësi dhe inkurajojnë personelin akademik të zhvillojë metoda të reja në mësimdhënie në përshtatje me zhvillimin e programit të studimit. Metodatat inovative shikohen edhe në mundësinë e përdorimit të teknologjisë dixhitale, për të krijuar ambiente nxënieje jashtë auditorëve.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në</p>	<p>UK ofron mundësi për kualifikim të vazhdueshëm të personelit, nëpërmjet kërkimeve dhe studimeve si brenda vendit ashtu edhe jashtë vendit. Kualifikimi jashtë vendit</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p> <p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p> <p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>realizohet nëpërmjet studimeve afat shkurtra ose afatgjata, si dhe nëpërmjet programeve të mobilitetit të pedagogëve (Aneksi I.35; Aneksi I.36)</p> <p>UK trajnon vazhdimisht personelin akademik, për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Kështu, stafi akademik trajnohet edhe nëpërmjet aktiviteteve, leksioneve të hapura, konsultimeve, ëork-shopeve etj, si dhe referimeve të lektorëve të jashtëm (Aneksi I.28).</p> <p>Sipas statutit dhe rregullores së UK-së (Aneksi I.02), personeli akademik dhe ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit.</p> <p>GVJ, gjatë vizitës në institucion konstatoi se stafi akademik dhe ndihmës akademik në UK, është i angazhuar në realizimin e detyrave në funksion të zbatimit të programit të studimit si dhe për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p> <p>Institucioni synon që të shtyjë përdorimin e platformave online (si p.sh., Moodle, që është një platformë që u jep mundësi pedagogëve dhe studentëve për një mësim të personalizuar) dhe në krijimin e ambjenteve dixhitale për mbarëvajtjen e procesit mësimor edhe gjatë kushteve të shkëputjes nga auditorët.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p> <p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titulari i lëndës/modulit.</p> <p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë</p>	<p>GVJ, nga vizita në institucion, takimet me përgjegjësen e Departamentit, Dekanen, stafin akademik, studentët si edhe nga dokumentacioni i depozituar nga institucioni konstatoi se, mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, përcaktohen në rregullore të posaçme siç janë Rregullorja e Brendshme e FE (Aneksi I.27), Kreu X, Nenet 73-75), Rregullorja e Departamentit Kreu IX, Nenet 31-33 (Aneksi I.42), Rregullorja e programit të studimit Bachelor në "Menaxhim" (Aneksi I.21).</p> <p>Në këto rregullore parashikohen të gjitha elementët e procesit të vlerësimit si detyra kursi, punë në grup, provimi i parë dhe provimi i dytë. Njohja e studentëve me këto rregullore shihet si një e drejtë dhe detyrim i tyre.</p> <p>GVJ konstatoi se studentët informohen nga stafi akademik në fillim të semestrit për, programin e lëndës, format alternative të vlerësimit dhe detyrimet që ata kanë, informacione që studentët mund t'i gjejnë edhe në syllabuset e lëndëve.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p> <p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p> <p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p> <p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p> <p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p> <p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ, nga vizita në institucion, takimet me Përgjegjësen e Departamentit, Dekanen, stafi akademik, studentët si edhe nga dokumentacioni i depozituar nga institucioni konstatoi se, mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, përcaktohen në rregullore të posaçme siç janë rregullorja e Rregulloren e Brendshme të FE (Aneksi I.27), Kreu X, Nenet 73-75 dhe Rregulloren e Departamentit Kreu IX, Nenet 31-33 (Aneksi I.42), Rregullorja e programit të studimit Bachelor "Menaxhim" (Aneksi I.21).</p> <p>GVJ, konkludon se vlerësimi është semestral, me komponente të tillë si: detyrat e kursit, esete, cilat zhvillohen gjatë semestrit, provimi i ndërmjetëm, detyra kursi vlerësohen në masën 30% dhe provimi final 70%. Të gjithë komponentët reflektohen në vlerësimin final.</p> <p>Gjithashtu, për të siguruar transparencën, objektivitetin e vlerësimit të njohurive të studentëve dhe për të shmangur rastet e subjektivizmin në vlerësime, sipas RVB, institucioni deklaron përdorimin e platformave si Google Classroom, Moodle, Office 365 for Education. Në fakt, ky përshkrim është gjeneral dhe nuk ka evidenca si bëhet vlerësimi online, që është një problem i përgjithshëm për çdo institucion edukimi.</p> <p>Nga komunikimi me stafin akademik dhe drejtuesen e njësisë bazë, rezultoi se testimi përfundimtar, sipas rregullores së UK-së, dhe rregullores së provimeve realizohet nga një komision, i cili ka jo më pak se 2 anëtarë të departamentit dhe titullari i lëndës (Aneksi I.02). Gjithashtu vlerësimi i praktikave profesionale dhe i diplomave (Aneksi I.27 dhe I.21), zhvillohen nga komisione me të paktën 3 anëtarë.</p> <p>Testimi bëhet me fletore të posaçme me logon e UK-së (që gjendet pranë librarisë universitare) dhe me sekretim.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit në Bachelor në "Menaxhim", këshillon dhe orienton studentët në lidhje me të gjithë elementet e vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale me qëllim për të ndihmuar studentët të përmirësohen në nxënie. Gjithashtu, lektorët ballafaqojnë vlerësimet e provimeve me studentët, ku, ata kanë mundësi të marrin feedback dhe të konsultojnë vlerësimin e tezave të tyre, në mënyrë që të shikohen përgjigjet korrekte. Nuk ka evidenca për paraqitjen e çelësit të tezës pas përfundimit të provimit.</p> <p>Provimet zhvillohen me mbikëqyrje nga komisioni për të shmangur kopjimin. Departamenti dhe personeli akademik respektojnë rregulloren e provimit në lidhje me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiature gjatë procesit të provimit (Aneksi I.27).</p> <p>Studentët i marrin vlerësimet i marrin Brenda 6 ditëve sipas rregulloreve përkatëse (Aneksi I.27 dhe Aneksi I.21). Studentët vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme përgjatë semestrit, vlerësime këto që janë komponentë të vlerësimit final. Teza ndërtohet bazuar në nivele të ndryshme njohurish, duke filluar nga të thjeshtat deri tek më të vështirat. Teza korrigjohet dhe brenda tre ditëve, studenteve ju</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>komunikohen rezultatet. Mbas përfundimit të procesit të vlerësimit teza depozitohet ne departament.</p> <p>Studenti ka të sanksionuar të drejtën për tu njohur me vlerësimin, me mënyrën e korrigjimit, për të qenë i qartë për gabimet në përgjigje dhe për vlerësimin sipas meritës. Staf i akademik mësues në këtë program studiimi, pas korrigjimit të tezës, mbledh pikët e të gjithë komponentëve të vlerësimit dhe publikon notën përfundimtare. Nga data e daljes së rezultatit përfundimtar studentët kanë të drejtë të kërkojnë rishikim të rezultatit. Përdoruesi bën rishikimin sipas rregullores së provimeve dhe vendos notën përfundimtare.</p> <p>Studenti e ka të sanksionuar të drejtën e ankimit për rezultatet. Procedura e ndjekur për ankimim, për zgjidhjen e ankesës si dhe vendimi i marrë realizohet në afate të përcaktuara. Brenda 8 ditëve nga provimi me shkrim, student mund të bëjë ankesën me shkrim drejtuar Dekanit, i cili pasi dëgjon palët, merr vendim brenda dy ditëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p> <p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p> <p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p> <p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p> <p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe informacionit të siguruar nga takimet me përgjegjësen e Departamenti, Dekanen, studentët dhe stafin akademik, rezultoi se programi i studimit Bachelor në “Menaxhim”, i cili përmban 34 lëndë (Aneksi I.24), garanton thellimin e njohurive dhe zhvillon aftësitë profesionale të studentëve në funksion të aplikimit të metodave teorike dhe praktike në lidhje me menaxhim.</p> <p>Objektivi kryesor i programit të studimit Bachelor në “Menaxhim” është t’u ofrojë studentëve njohuri bazë teorike dhe praktike, për formimin e studentëve si specialistë / administratorë në sektorin publik, në sektorin privat, si dhe në sektorin jofitimprurës.</p> <p>Gjithashtu, ai synon që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të formojë specialistë me njohuri dhe kompetenca profesionale, për të rritur mundësitë e tyre në tregun e punës. • T’u ofrojë studentëve rritje profesionale dhe mundësi zhvillimi përmes angazhimit aktiv të tyre në praktikën profesionale dhe në diskutime dhe këshillime të drejtuara nga specialistë të fushave të ndryshme të aktivitetit ekonomik. • Të përgatisë profesionistë, të motivuar për të punuar në të gjithë sektorët e Rajonit dhe më gjerë, për të ndihmuar në zhvillimin e tyre, si dhe në zhvillimin ekonomik të vendit. • Të sigurojë një bazë të shëndoshë teorike dhe praktike, për t’u mundësuar studentëve ndjekjen e karrierës së ardhshme profesionale. • Të promovojë sjellje etike dhe profesionale. <p>Plani mësimor (Aneksi II.01) dhe programet lëndore (Aneksi, I.25/2019-2020; 2018-2019; 2017-2018), paraqesin organizimin e lëndëve dhe dijeve që formohen nga programi i studimit në Bachelor në “Menaxhim”. Përveç lëndëve të përgjithshme, program synon edhe njohjen me programe profesionale, si Alfa, SQL, Oracle, Visual Studio në disa nga lëndët si Informatika, E-Biznes, Kontabilitetit Drejtimi, ku leksionet zhvillohen në laboratore.</p>

<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p> <p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p> <p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p> <p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p> <p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Gjithashtu, lëndët e Sociologji, E drejtë biznesi, Komunikim në biznes, Gjuhë e huaj, i jep studentëve informacion në shkencat sociale.</p> <p>Në fillim të semestrit, studentët marrin informacion rreth mënyrës së organizimit të lëndës, objektivat e lëndës dhe rezultatet e pritshme. Në syllabuset e lëndëve studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në lëndën përkatëse. Këtu ato njihen me temat, kohëzgjatjen e kursit, frekuentimin, mënyrën e vlerësimit, si dhe literaturën bazë dhe plotësuese. Syllabusi përmban edhe numrin e krediteve të lëndës.</p> <p>Referuar informacionit të siguruar nga studentët e programit si dhe nga pedagogët, në seancën e fundit të semestrit çdo pedagog në fund të semestrit mbas përfundimit të lëndës, realizon një përmbledhje të temave kryesore dhe analizon çështjet e ndryshme që janë konstatuar gjatë trajtimit si të panevojshme apo të pa plotësuara.</p> <p>Gjithashtu, në grupet mësimore diskutohen çështje për përmirësimin në vazhdimësi të syllabusit si dhe çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin në vazhdimësi të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe në mënyrë të strukturuar i paraqiten departamentit për diskutim.</p> <p>GVJ, konstaton se në përfundim të leksioneve çdo pedagog organizon një seancë përmblylëse e të gjitha temave, ku studentët sqarohen për paqartësitë dhe orientohen për përgatitjen e provimit përfundimtar. Pedagogu në përfundim vë në dispozicion të studentëve literaturën e nevojshme të përmbledhur dhe orienton studentët tek ato pjesë më të rëndësishme që duhen përgatitur për provim. Të gjithë pedagogët e lëndëve shpallin oraret e konsultimeve.</p> <p>Nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion dhe nga RVB, rezultojnë se personeli akademik i programit Bachelor në “Menaxhim”, zhvillon aktivitete të ndryshme të tilla si, orë të hapura (Aneksi I.28) dhe seminare mbi çështje që lidhen me situatën dhe problemet aktuale të zhvillimit të marketingut dixhital dhe ku, informohen rreth inovacioneve dhe arritjeve të shkencës. Seminaret zhvillohen në mënyrë interaktive, me synim inkurajimin e pjesëmarrjes së studentëve në diskutime, proces përmes të cilit ata arrijnë të qartësojnë dhe krijojnë ide, të bëjnë aplikime të ndryshme, të formulojnë dhe realizojnë ide, projekte dhe qëllime të caktuara.</p> <p>Referuar planit mësimor, syllabuseve si dhe takimeve me stafin dhe studentët e programit, rezultojnë se në procesin e mësimdhënies organizimi i orës së mësimi i përshtatet natyrës së lëndëve dhe synon angazhimin e të gjithë studentëve për një nxënie optimale, zhvillim kompetencash si dhe aplikim i njohurive të siguruar nga teoria. Ka lëndë në program, që zhvillohen në kushtet laboratorike nëpërmjet kompjuterëve mbi bazën e aplikacioneve të ndryshme si dhe nëpërmjet sistemit të internetit.</p> <p>Studentët inkurajohen të punojnë në mënyrë individuale ose në grupe për të realizuar një projekt, detyrë kursi apo stimulim i zgjidhjes së një problemi biznesi në fushën e menaxhimit. Nën drejtimin e pedagogut të lëndës, organizohen seminare, motivohen dhe inkurajohen studentët për të dhënë mendime për çështje të caktuara, duke i ndarë studentët në grupe sipas roleve që do të luajnë dhe secili grup përfaqëson një grup interesi në tregun imagjinar.</p> <p>Stafi akademik mbështet idetë inovative të studentëve në zgjidhjen e problemeve të marketingut dhe identifikon momentet që kanë nevojë për më shumë informacion dhe studim të mëtejshëm. Këto probleme bëhen objekt i kërkimeve të mëtejshme duke u materializuar në tema diplome. Pedagogët komunikojnë mjaft mirë me studentët duke bërë që procesi mësimor të zhvillohet në mënyrë të natyrshme dhe pa sforcime. I gjithë ky proces monitorohet dhe një nga mënyrat është edhe pyetësori që bëhet në fund të lëndës me studentët. Nga RVB shikohet edhe pjesëmarrja e studentëve në konferenca shkencore rajonale.</p>
--	--

	Ekzistojnë një seri bashkëpunimesh me kompani të territorit (Aneksi I.35 dhe I.36), që ftohen nga personeli akademik, për të rritur mundësitë e studentëve për të patur eksperiencën profesionale dhe akademike plotësuese.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p> <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p> <p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p> <p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p> <p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Bazuar në RVB, vizita në institucion si dhe nga takimi me përgjegjësen e Departamentit, stafi akademik, studentët e programit të studimit, rezultoi procedura e diplomimit është e rregulluar me Rregulloren FE (Aneksi I.27), Rregulloren e Programit të Studimit (Aneksi I.21) dhe Udhëzuesi i Diplomës (Aneksi II.04). Ky i fundit gjendet pranë zyrës së informimit të studentëve, FE dhe në faqen e internetit të UK (https://www.unkorce.edu.al/sites/all/themes/tb_university/programet_studimet/FE/docs/Udhzues%20Punim%20Diplome%20%20%20%20Prog.Stud.MENAXHIM.pdf)</p> <p>Personeli akademik asiston studentët duke vënë në dispozicion të tyre të gjitha informacionet e nevojshme në funksion të përgatitjes dhe mbrojtjes së mikrotezës. Gjithashtu, për përgatitjen dhe mbrojtjen e diplomës studentët kanë mundësinë e një laborator informatik i pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme që të bëjë të mundur përpunimin praktik të ideve teorike të shtruar nga studentët për zgjidhje praktike.</p> <p>Mbrojtja e diplomës bëhet para një komisioni të përbërë nga staf akademik, i propozuar nga njësi bazë dhe i miratuar nga dekani. Vlerësimi i punimit bëhet bazuar në origjinalitetin, saktësinë shkencore, saktësinë e të shkruarit, mënyrën e prezantimit etj.</p> <p>Referuar rregullores së mbrojtjes së diplomave, puna fillon me përcaktimin e listës së kandidatëve udhëheqës, ku studentët mund të kontaktojnë me ç' do njerin prej emrave të listuar me qëllim që të marrin orientimin e duhur për përcaktimin e fushës së kërkimit në kuadrin e përgatitjes së mikrotezës në mbrojtje të diplomës.</p> <p>Institucioni ka kapacitetet e duhura për t'i asistuar studentët në përgatitjen e punimit të temës sipas fushës së studimit. Për të realizuar kërkimin e tyre shkencor studentë e programit të studimit, kanë në dispozicion të tyre të gjitha burimet didaktike, informatike, salla, labore kompjuterash dhe bibliotekën.</p> <p>GVJ konstaton se udhëheqësi i diplomës pas përcaktimit të programit të punës së studentit, për realizimin e diplomës si dhe afatet e përfundimit të saj, është në kontakt të vazhdueshëm me studentin për përpunimin e të dhënave dhe nxjerrjen e rezultateve. Në fund udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studentin, garanton origjinalitetin e punimit dhe cilësinë e rezultateve si dhe lejon mbrojtjen e tij, duke e nënshkruar. Mendimi i udhëheqësit shprehet nëpërmjet vlerësimit final.</p> <p>Referuar rregullores së diplomimit, komisioni bazuar në prezantimin e punimit nga studentin e vlerëson atë me pike, të cilat më tej konvertohen në notën përfundimtare të vlerësimit të punimit të diplomës, sipas rregullave të UK, FE dhe Programit të Studimit (Aneksi I.27; Aneksi I.21) për kontrollin e dijeve dhe arritjet e studentit gjatë ciklit të studimit (Aneksi III.07).</p>

<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p> <p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> <p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Siç është e parashikuar në rregulloren e FE (Aneksi I.27), bazuar të ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, në përfundim të studimeve në programin Bachelor në “Menaxhim”, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës sipas modelit të aprovuar nga Ministria (Aneksi II.07).</p> <p>Dorëzimi i diplomës bëhet në ceremoninë e diplomimit (Dita Akademike), që organizohet nga UK.</p> <p>Në përfundim të studimeve studenti merr diplomën se bashku me suplementin. Institucioni, me kërkesë të studentit, i ve në dispozicion një kopje te plote zyrtare te programit të studimit.</p> <p>Bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale i gjithë dokumentacioni për studentët përpunohet dhe ruhet nga institucioni.</p>			
	<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p>Standardi IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Bazuar në RVB, takimin me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, GVJ konstaton se administrimi i bazës së të dhënave mbi personelin akademik, ndihmës mësor, shkencor dhe administrativ, bëhet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit në UK (Aneksi I.04). Këto të dhëna ruhen për çdo vit akademik, për gjithë stafin akademik që përfshihet në program. Këto të dhëna, përmbajnë emrat e stafit akademik, lëndët për çdo semestër, orët mësimore dhe ngarkesën totale si dhe statusin e tij (Aneksi IV.09).</p> <p>Referuar RVB, UK garanton transparencën ndaj publikut, paanshmërinë, shanse të barabarta të konkurimit dhe zbatim rigoroz të kriterëve ligjore të parashikuara në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, Neni 64, Pika (1) dhe Kodit të Punës. Kriteret e përgjithshme parashikohen nga Rregullorja e FE (Aneksi I.02). Kriteret specifike të punësimit të personelit akademik përcaktohen nga njësi bazë, në bazë të nevojave dhe miratohen nga rektori (Aneksi I.01).</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë për zgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Vendit vakant shpallet në Buletin e Njoftimeve Publike (VKM Nr.176. dt. 29.03.2006 "Per botimin e Buletinit të Njoftimeve Publike") dhe në faqen web të UK (modeli Aneksi IV.02). Kandidatëve potenciale ju jepet mundësia të paraqesin dokumentacionin brenda afateve të përcaktuara.</p> <p>Udhezirmit i Rektorit të UK., Nr. 594, dt. 08.10.2018 "Për vlerësimin e kandidatëve që punësohen si personel akademik" (Aneksi I.13), rregullon mënyrat e vlerësimit të kandidatëve. Pas kontrollit të dokumentacionit pranë FE për rekrutimet, GVJ, vlerëson procedura është e rregullt.</p>			
	<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Bazuar në RVB, vizita në institucion si dhe nga takimi me përgjegjësen e Departamentit, Dekanen dhe stafin akademik të programit të studimit, konstatohet se institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit të përshtatshëm për personelin. Institucioni ka siguruar investime, të cilat ofrojnë mjedise të mirëpajisura për çdo anëtar të stafit akademik dhe administrativ, që u krijon mundësi për realizimin e detyrave të tyre profesionale (Aneksi III.04).</p> <p>UK dhe FE mbështet stafin e tij për kualifikim të mëtejshëm (Aneksi IV.08). Institucioni promovon programe në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim, që kanë të bëjnë me sigurimin e të dhënave shkencore, përditësimin e materialit didaktik, pjesëmarrjen në konferenca e seminare kombëtare e rajonale, organizimin e konferencave etj. Stafi zhvillon takime të rregullta brenda departamentit si për vetë kualifikimin e tij, ashtu dhe për marrjen e vendimeve të rëndësishme që lidhen me mësimdhënien, studentët dhe probleme të tjera.</p> <p>Ne kuadër të programit "ERASMUS", pedagoget e brendshëm kanë marrë pjesë në shkëmbime në vënde të Bashkimit Europian.</p> <p>Rezulton se mbështetja e institucionit me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e mësimin me metodat inovative, ka përmirësuar ndjeshëm mësimdhënien, nëpërmjet eksperiencave në universitete të ndryshme europiane, por edhe brenda vendit. Zyrat</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>dhe sallat ku realizohet procesi mësimor janë të kompletuara me të gjitha mjetet e nevojshme, me kompjuter me programet përkatëse, me projektor, etj.</p> <p>Gjithashtu, përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie (Google, eduMeet, Google Meet, Google Classroom, Office 365 for Education) inkurajon në metoda të reja mësimdhënieje.</p> <p>Departamenti dëshmon për një angazhim të burimeve njerëzore, stafit akademik dhe atij administrativ, për përmbushjen e objektivave të programit të studimit 85% e stafit ka kualifikime shkencore (Aneksi I.33 dhe Aneksi II.10). Plani mësimor, syllabuset, orari i mësimit si dhe dokumentet që stafi akademik depoziton në departament etj., flasin për një staf akademik të angazhuar për përmbushjen e objektivave të këtij programi studimi, gjë që u konstatua edhe në takimin me studentët.</p> <p>Nga vizita në institucion GVJ, konstaton gjithashtu, se edhe stafi administrativ dëshmon përkushtim në realizimin e detyrave të programit të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> <p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> <p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të</p>	<p>Referuar RVB-së, vizitës në institucion GVJ konstatoi se institucioni disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e mësimit të programit të studimit Bachelor në “Menaxhim” (Aneksi III.04)</p> <p>Godina, ku zhvillohet mësimi i këtij programi studimi, është e pajisur me mjediset bashkëkohore si auditore, laboratore, bibliotekë etj, mjaft të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor në përputhje me numrin e studentëve dhe veçorititë specifike të programit të studimit.</p> <p>Në laboratore, për secilin student janë vënë kompjutera, ku studentët përdorin programet e instaluar, internetin dhe platforma te ndryshme. Kompjuterët, projektorët, interneti, janë të mjaftueshme për realizimin e procesit mësimor të studentëve.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ambjentet e stafit akademik përmbushen sipas kërkesave specifike. • Klasat, laboratorët dhe mjediset e tjera, disponojnë infrastrukturë dhe logjistikë të pranueshme dhe të nevojshme si, poste ulje, tavolina, pod lekturimi, tabela, videoprojektor etj., që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik, përmes përdorimit të teknologjisë bashkëkohore në mësimdhënie. • Laboratorët janë dy: (i) ai i kompjuterizimit financiar me 30 kompjutera me programet bazë dhe specifike të kontabilitetit si Alfa; dhe ai (ii) i Hoteleri-Turizmit. • Institucioni disponon infrastrukturën e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme referuar programit.

<p>objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Institucioni garanton bashkëpunime me organizata të tjera që operojnë në territor, duke krijuar mundësi të mira për eksperiencën e studentëve si edhe duke mundësuar një punësim të mëtejshëm në të njëjtat institucione (Aneksi I.36)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Duke iu referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se biblioteka siguron mjediset e duhura në të cilat studentët e ketij programi studimi, kanë mundësi të barabarta për të marrë shërbime si për të studiuar ashtu edhe për të shfrytëzuar literaturën e tyre. Biblioteka numëron rreth 5316 libra (Aneksi III.06), që mund të merren në shfrytëzim brenda hapësirave të saj apo jashtë (për një periudhë të caktuar kohore). Biblioteka ka 43 vende.</p> <p>Studentët kanë në dispozicion tekste mësimore të hartuara nga pedagogë me emër të universiteteve të tjera në vend. FE, ka siguruar një numër të konsiderueshëm tekstesh në mbështetje të programeve të studimit. Numri i kopjeve të disponueshme, është i mjaftueshëm në raport me numrin e studentëve të regjistruar.</p> <p>GVJ konstatoi prezencën e librave dhe literaturës ndihmëse fizike, por edhe faktin që studentët kanë akses në shfrytëzimin e kapaciteteve të bibliotekës, pa pagesë duke ofruar edhe platforma online. Studentët dhe stafi i UK-se ka akses në Bibliotekën Dixhitale U-Library nga RASH (https://ulibrary.rash.al/), që mundëson akses në EBSCO Publishing Databases.</p> <p>Nuk u konstatuan instalime kompjuterike në bibliotekë. GVJ Duke marrë parasysh Shtojcën 1, “Praktika për shtimin e titujve të bibliotekës”, konstatohet një listë e gjërë titujsh me interes për programin e menaxhimit (si p.sh., innovation and entrepreneurship, managerial accounting, public finance, etj.), Orari i hapjes së bibliotekës është publik: 08.00 – 16.00, nga e hëna në të premte. Mund të aksesojnë të gjithë studentët me kartelë.</p>

<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p> <p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion pranë sekretarisë mësimore, GVJ konstaton se të dhënat dhe informacionet në lidhje me studentët dhe veprimtarinë e tyre regjistrohen dhe arkivohen nga sekretaria mësimore.</p> <p>Në bazë të marrëveshjes me RASH (Aneksi III.05), UK ka akses në disa aplikacione të ESSE3, ndër të cilat garantohej edhe menaxhimi i studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sekretaria mësimore përpunon të gjithë dokumentacionin e studentit, duke krijuar për çdo student dosje në hard copy, që pasqyrojnë dokumentacionin e nevojshëm, të gjitha rezultatet e provimeve, të prezencës në mësim, të dhënat mbi bursat apo tarifën e studimit dhe masa disiplinore të marra në qoftë se ka deri në diplomimin e tyre.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ verifikoi mbajtjen e regjistrave manual nga sekretaria mësimore në lidhje me studentët e programit.</p> <p>Pedagogët përgatishin regjistrin e tyre (sipas Rregullores së FE, Aneksi I.27) nën përgjegjësinë e tyre. Ky regjistër monitorohet nga drejtuesi i njësisë bazë.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi ESSE3, garanton akses në informacion dhe dokumente mbi të gjithë stafin akademik dhe studentët. Manuali është paraqitur në Aneksin I.06.</p> <p>Rezulton se në institucion, për komunikimin interaktiv të stafit akademik me studentët përdoren emaili dhe sistemi Moodle, Google Meet, Google Classroom si dhe platforma të tjera.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë formën të</p>	<p>Sistemi pasqyrojnë kalendarin akademik, planin mësimor sipas programeve dhe semestrave, grupet mësimore, orari, dhe klasat. Ndërsa studentët mund të ndjekë në kohë reale materialet didaktike, frekuentimin, rezultatet dhe pedagogët pasqyrojnë</p>

<p>komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p> <p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p> <p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>syllabusin e lëndës, materialet didaktike si dhe vleresimet e pjesëshme dhe përfundimare të studentëve.</p> <p>GVJ konstaton se webi i institucionit është funksional, ai është dy gjuhësh, shqip dhe anglisht. Në web GVJ, konstatohet të dhëna, rreth fakultetit, departamentit, programeve të studimit, syllabuseve etj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p> <p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Si institucion universitar publik, UK funksionon në bazë të parimit të autonomies financiare (sipas Ligjit të Arsimit të Lartë, 80/2015). Statuti i UK (Aneksi I.01) përcakton sipas ligjit, administrimin e çështjeve financiare. Projekt-buxheti diskutohet në nivel institucioni në përfundim të çdo viti akademik. Pas aprovimit në Senat dhe me kërkesën e tij, bordi i administrimit miraton projekt-buxhetin. Kosto për student paraqitet në Aneksin IV.10, ndërsa të dhënat për të ardhurat dhe realizimi faktik paraqiten në Aneksin IV.10</p> <p>Burimet e financimit janë: Buxheti i Shtetit, pagesat e studentëve, të ardhura nga shërbimet e kryera, donacione, dhe të ardhura nga veprimtaria shkencore.</p> <p>Mënyra e përdorimit të fondeve mund të shikohet në Rregulloren Financiare dhe të Shpërndarjes të së Ardhurave (Aneksi IV.12).</p> <p>Projekt buxheti afat mesëm (i përcaktuar në Statut të UK – Aneksi I.01), kryhet në semestrin e dytë të çdo viti, duke mbledhur kërkesat nga njësitë kryesore dhe ndihmëse.</p> <p>Si institucion shtetëror, UK dorëzon pranë MASR dhe Thesarit pasqyrat ekonomike financiare vjetore. Gjithashtu UK i nënshtrohet auditimit të jashtëm nga MASR dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit. Rezultatet publikohen në faqen e UK apo tek Kontrolli i Lartë i Shtetit (http://www.klsh.org.al/web/raporti_universiteti_korces_2_korrik_ëeb_4368.pdf)</p> <p>GVJ nuk arriti të gjejë një seksion mbi rezultatet e auditimit pranë faqes së UK.</p> <p>Sipas RVB, raportet financiare diskutohen në organet kolegjiale të UK: Rektorat, Bord Administrimi dhe Senat. Nuk ka evidence në RVB për këtë.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p> <p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Qëndrueshmëria institucionale garantohet nga Bordi i Administrimit, duke patur hyrje të sigurta jo vetëm nga studentët por edhe nga fondi i MASR. UK ka mjetet e nevojshme financiare për realizmin me sukses të procesit mësimor, se edhe në të kaluarën nuk ka pasur probleme në drejtim të mos financimit.</p>			
	<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p>Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ vlerëson se në përcaktimin e kritereve pranuese të UK në programin Bachelor në “Menaxhim”, institucioni ndjek të njëjtat politika dhe praktika si edhe për programet e tjera të studimit. Procedurat dhe kriteret e pranimit janë në përputhje me politikat e institucionit. Kriteret dhe procedurat e pranimit janë në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara në legjislacion dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> <p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p> <p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p> <p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>specifikohen gjithashtu në statutin e UK (Aneksi I.01) , rregulloren e FE (Aneksi I.27), si dhe në rregulloren e programit të studimit (Aneksi I.21)</p> <p>Gjithashtu gjeihen procedura të tjera të publikuara në Udhëzuesin e Praktikës (Aneksi I.40) dhe ai i Diplomës (Aneksi II.04).</p> <p>Procedurat për hyrjen dhe ndjekjen e programit i referohen dhe respektojnë barazinë dhe të drejtat për çdo student. Të gjitha procedurat e shoqerojnë studentin përgjatë programit.</p> <p>Të gjitha këto procedura janë të pasqyruara edhe në rregulloret përkatëse dhe procesi ndiqet në të gjitha njësitë për miratim (njësi bazë, njësi kryesore, rektorat, senat akademik, MASR).</p> <p>Pranimi i kandidatëve në këtë program studimi bazohet në udhëzimet e MASR si përsa i përket afateve ashtu edhe për dokumentacionin që nevojitet për regjistrim. Regjistrimi në sekretarinë elektronike ESSE3, garanton barazinë midis studentëve.</p> <p>Transparenca, aksesueshmeria dhe kuptueshmëria e informacioneve që lidhen me programin e studimit në UK dhe në FE, për kandidatët dhe për të gjithë të interesuarit e tjerë për të vazhduar studimet në kete program studimi, bëhen të mundura nëpërmjet kanaleve formale të komunikimit si dhe mjeteve të komunikimit. E gjitha kjo procedurë bazohet në statutin e UK (Aneksi I.01), në rregulloren e FE (Aneksi I.27), në rregulloren e programit të studimit (Aneksi I.21). Studentët kanë akses në Udhërrëfyesin që pasqyron të gjitha informacionet në lidhje me kriteret, procedurat e pranimit, përzgjedhjes, përparimit, transferimit, njohjes së studimeve, etj. (https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/udherrefyesi2020.pdf).</p> <p>Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike të pranimit të studentëve hartohen dhe zbatohen në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe akteve nënligjore të MASR. Të gjitha këto procedura janë të pasqyruara edhe në rregulloret përkatëse dhe procesi monitorohet në të gjitha njësitë (njësi bazë, njësi kryesore, rektorat). Çdo shtetas i huaj mund të regjistrohet si student në programin e studimit Bachelor në "Menaxhim", bazuar në kriteret e përcaktuara nga MARS, Statuti dhe Rregullorja e Brendshme e FE.</p> <p>GVJ konstaton se, kandidatët që duan të ndjekin studimet në ciklin e dytë si dhe i gjithë publiku informohen përpara fillimit të çdo viti akademik në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike që kërkohen për tu regjistruar në këtë program studimi. Veprimtaria "Ditët e informimit të Maturantëve" shërbejnë për informim direkt dhe sa më të plotë të kandidatëve në qarkun e Korçës për programet e mësimit që ofrohen nga Departamenti i Menaxhimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p> <p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ konstaton se njësia bazë, sekretaria mësimore dhe Zyra e informimit dhe orientimit të studentëve në FE, vënë në dispozicion informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret që duhet të ndiqen dhe procedurat e zbatuara për përparimin akademik të studentëve, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet rregullatore të brendshme, rregullorja e programit të studimit dhe Rregullorja e Brendshme e FE (Aneksi I.27). Gjithashtu, stafi i angazhuar në këtë program studimi dhe sekretaria mësimore, vënë në dispozicion të studentëve syllabuset si dhe kriteret për kalimin nga një vit në tjetrin. Nga sa më sipër GVJ, konstaton që institucioni është i pajisur me strukturat përkatëse si dhe me procedurat e rregulluara dhe zbatuara nga strukturat përgjegjëse për këtë program studimi.</p> <p>Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe rregullat e njohjes dhe ekuivalentimit të diplomave si dhe kriteret dhe rregullat e transferimit të studentëve, qoftë përmes faqes ëeb të Universitetit ashtu edhe nga sekretaria mësimore e FE dhe drejtuesi i njësisë bazë. Studentët që aplikojnë për transferimin informohen mbi vendimin e Komisionit të Njohjes dhe Ekuivalentimit nga institucioni, përmes shpalljes së fituesve në stendat informuese të vendosura në ambientet e fakultetit si dhe sekretarisë mësimore, zyrës së informimit dhe orientimit të studentëve dhe drejtuesit të njësisë bazë.</p> <p>Në lidhje me procedurat e vlerësimit të dijeve, studenti informohet, nëpërmjet Rregullores së Brendshme të FE-së dhe rregullores së programit të studimit, ku këto kritere janë të detajuara dhe ku përcaktohet forma e kontrollit të dijeve si dhe procedurat e vlerësimit të dijeve deri në diplomim. Referuar dokumentacionit, GVJ vëren që për këtë program studimi ka indikatorët të matshëm për vlerësimin e dijeve dhe aftësive, mënyrën e zhvillimit të provimeve, praktikës profesionale dhe cilësisë së punimit të diplomës nga studenti. Të gjitha informacionet lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit të përfshira në këto dokumente, ju bëhen të njohura studentëve në fillim të procesit mësimor nga pedagogu i lëndës si dhe në mënyrë individuale përmes sistemit ESSE3.</p> <p>Në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit, studenti informohet, nëpërmjet Rregullores së Brendshme të FE (Aneksi I.27) - neni 40 dhe 42; Rregullores së programit të studimit - seksioni 14/B, si dhe Udhëzuesit të Diplomës ku këto kritere dhe procedura janë të detajuara. GVJ, nga takimi i realizuar me stafin e angazhuar në programin e studimit, me studentët e programit si dhe referuar dokumentacionit, konstaton se studentët informohen me të gjitha kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe të diplomimit nëpërmjet sekretarisë, departamentit dhe sektorit të shërbimit ndaj studentëve, si dhe ëeb faqes së Universitetit.</p> <p>Departamenti i Menaxhimit si njësi bazë përgjegjëse për prgramin Bachelor në “Menaxhim”, së bashku me QKA informojnë para fillimit të çdo viti akademik punon intensivisht për tërheqjen e kandidatëve potencialë pranë Fakultetit Ekonomik, duke ndërmarrë një sërë veprimtarish informuese në platformat online (publikime në faqen e ëeb, rrjete sociale etj) dhe përmes vizitave informuese në shkollat e mesme të përgjithshme dhe profesionale të Qarkut të Korçës. Përmbajtja e këtyre veprimtarive konsiston në informimin e të interesuarve në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit, mundësitë që krijon për punësim etj. Nga sa më sipër, GVJ konstaton që kriteret plotësohen, institucioni është i pajisur me strukturat përkatëse si dhe procedurat e rregulluara dhe zbatuara nga strukturat përgjegjëse për këtë program studimi.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.3				
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p> <p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> <p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Bazuar në RVB, vizitës në institucion, GVJ vlerëson se studentët informohen në mënyra të ndryshme për strukturën e programit të studimit. Në fillim të çdo viti akademik, njësi bazë përgjegjëse së bashku me QKA-në organizojnë takime informuese dhe të përshtatjes me fakultetin, ndërsa pedagogët e programit informojnë studentët në lidhje me strukturën dhe organizimin e lëndëve që mbulojnë. Gjithashtu bëhet edhe informim përmes zyrës së informimit dhe orientimit të studentëve, sekretaria mësimore e FE si dhe informacionit të paraqitur në faqen ëeb të UK dhe fletëpalosjeve informuese të FE.</p> <p>Institucioni jep informacion, lidhur me programet e studimit (Aneksi I.21), planin mësimor (II.01) lëndët dhe përmbajtjen e tyre në mënyrë të hollësishme në rregulloren e programit të studimit, syllabuset e lëndëve, nëpërmjet takimeve me stafin akademik etj.</p> <p>Plani mësimor gjendet edhe pranë zyrës së informimit dhe orientimit të studentëve, sekretarisë mësimore, stendet në ambjentet e fakultetit si edhe në faqen ëeb të UK.</p> <p>Institucioni është i pajisur me struktura që krijojnë mundësinë për informimin e studentëve dhe lehtësojnë tranzicionin e tyre drejt tregut të punës. QKA, informon, orienton dhe këshillon studentët për mundësitë e punësimit. QKA është struktura përgjegjëse që zhvillon dhe drejton procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit, krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët/alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, zhvillon komunikimin efektiv dhe etik me studentët, alumnit, stafin dhe të tjerë.</p> <p>Studentëve u vihet në dispozicion një informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Ato mund marrin informacionin nga pedagogët, përgjegjësi i departamentit, seksionet e web-it të UK, mediat sociale.</p> <p>Sipas RVB-së sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit ju ofrohet studentëve në kohë dhe me cilësinë e kërkuar nëpërmjet platformave përkatëse si p.sh. ESSE3. Informacioni në lidhje me programin e studimit bëhet i aksesueshëm nga studentët edhe nga publikimet në faqen elektronike zyrtare të UK.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të	Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ konkludon se institucioni disponon të dhëna sipas viteve për studentët që kanë aplikuar, numrin e studentëve që

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+3.55 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>diplomuarve për çdo program studimi.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p> <p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>vazhdojnë studimet dhe studentëve të diplomuar në programe. Këto të dhëna ruhen dhe përpunohen nga sekretaria mesimore e FE dhe nga SPKSD.</p> <p>Për çdo student sekretaria mesimore disponon dosjet e studentëve, të cilat përmbajnë të dhënat që nga regjistrimi, ndjekja e studimeve deri në përfundim me diplomimin e tyre.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion, konsultoi rregjistrat themelor ku çdo student është regjistruar dhe është pajisur me numër matrikullimi. Aktualisht numri i studentëve në këtë program studimi është 126.</p> <p>Gjithashtu GVJ konsultoi dosje të studentëve të regjistruar, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar, si: listë notash, kontrata, aneks kontrata, deklarata e studentit, dokumenti i identifikimit, diploma e shkollës së mesme, lista e notave dhe fotografi.</p> <p>Të dhënat statistikore, për programin e studimit, menaxhohen kryesisht nga sekretaria mesimore e FE. Sipas Rregullores së Sekretarisë (Aneksi I.10) Sekretaria mesimore çdo vit përgatit të dhëna statistikore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar, të larguar, të çregjistruar etj, duke përdorur edhe sistemin ESSE3. Statistikat e përgatitura ruhen në formë elektronike (që nga 2007) dhe hard-copy.</p> <p>Institucioni disponon të dhëna në lidhje me ecurinë e studentëve gjatë viteve akademike nga 1992 (hapja e programit), të cilat grumbullohen dhe përpunohen nga sekretaria mesimore e FE. Në përputhje me udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe të organeve drejtuese të UK, këto të dhëna shënohen në regjistrin e tërhequr nga institucioni për matrikullimin e studentëve. Në fund të çdo sezoni provimesh lektori i lëndës depoziton pranë sekretarisë së fakultetit proces verbalin me listën e studentëve dhe notat përkatëse si dhe një evidencë mbi pikët e fituara gjatë vitit në elementët e ndryshëm të kontrollit të dijeve si dhe pikët përfundimtare të marra në provim. Në bazë të këtyre të dhënave sekretaria mesimore bën pasqyrimin e notave në regjistrat e arritjeve akademike.</p> <p>Të dhënat statistikore të studentëve të nxjerra nga sekretaria mesimore e FE, menaxhohen dhe ruhen elektronikisht (në sistemin ESSE3 si edhe në dosje fizike nga personat e autorizuar.</p> <p>Të dhënat janë konfidenciale dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> <p>Institucioni harton raporte analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Në këto raporte analizohet situata aktuale dhe bëhet krahasimi me vitet e kaluara. QKA dhe UK publikojnë raportin e tyre (Aneks I.23), për të analizuar veprimtarinë dhe e qendrës së karrierës dhe alumni.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në</p>	<p>Bazuar në RVB, vizitën në institucion dhe takimet me studentët, GVJ vlerëson se studentët janë të përfaqësuar në organet vendimmarrëse të UK sipas rregullave ligjore</p>

<p>organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p> <p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p> <p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>në fuqi (Ligji i arsimit të lartë, 80/2015; Statuti i UK – Aneksi I.01). Ata janë anëtarë me të drejtë vote dhe me të drejta të barabarta me përfaqësuesit e personelit akademik.</p> <p>Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senatin Akademik dhe në komisione të tjera si • Këshilli i etikës të UK • NJBSC. • Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) dhe ai i Zgjedhjeve në Fakultet (KZF). <p>Studentët zgjedhin përfaqësuesit e tyre, nëpërmjet një procesi zgjedhor transparent të garantuar nga ligji dhe institucioni. Gjithashtu ato organizohen në Këshilla Studentorë sipas Rregullores së Këshillit Studentor (Aneksi I.17).</p> <p>Në përputhje me dispozitat ligjore (VKM 41 24.1.2018, Aneksi II.02) departamenti ka parashikuar ngarkesa akademike e studentëve për të gjitha programet e studimit si dhe për programin që po akreditohet. Programi i studimit parashikon njohjen e studimeve të pjesshme apo të plota të kryera më pare duke u bazuar në ligjin e Arsimit të lartë 80/2015, në urdhëra dhe udhëzime të ndryshme të Ministrisë së Arsimit.</p> <p>Plani mësimor respekton ngarkesën javore në auditor (maksimumi 25 orë në javë / 50 minutëshe) (Aneksi II.01) dhe sipas rregullores së programit të studimit, numri total i orëve në auditor varion nga 645 në 750 orë (Aneksi I.21)</p> <p>Institucioni është i hapur ndaj sugjerimeve të studentëve për përmirësimin e programit të studimit. Tërheqja e mendimeve bëhet nga NJBSC në fund të semestrit kur analizohen aftësitë dhe kompetencat e marra gjatë lëndës dhe problemet që janë evidentuar. Gjithashtu, FE realizon çdo fund viti, rishikimin e programit të studimit, nëpërmjet informacionit që mbledh nga pyetëtori i studentëve (Aneksi III.01), këshilli studentor FE, relacionet e pedagogëve.</p> <p>FE në rregulloren e tij (Aneksi I.27), ka parashikuar procedurën që siguron ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë këtu mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit, njësisë dhe pedagogut përgjegjës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Bazuar në RVB, vizitën në institucion, takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ vlerëson se institucioni ka kapacitetet dhe infrastrukturën për orientimin dhe informimin e studentëve. Rregullorja e FE (Aneksi I.27) përcakton mënyrat e komunikimit me studentët, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Faqen web (që është funksionale dhe e mirëorganizuar) • Takime të drejtpërdrejta me studentët me strukturat apo stafin akademik. • Teknologjinë: Google Meet, Google Classroom, Moodle, eduMeet, lejojne komunikimet e vazhdueshme me studentët. • Stendave komunikuese në brendësi të ambjenteve të FE <p>Gjithashtu, zyra e informimit dhe orientimit ndaj studentëve është funksionale, duke i garantuar studentëve informacione në kohë reale mbi programet e studimit, progresin akademik, etj. Edhe sekretaria mësimore luan një rol informues për studentët, për notat e marra, apo ecurinë akademike. Këshilli studentor është funksional dhe veprimtaria e tij njihet nga studentët.</p> <p>Si pjesë e rëndësishme e zbatimit të politikës institucionale për orintimin e karrierës së studentëve është edhe QKA (zyrë e vendosur brenda KSCK). Kjo qendër ofron shërbime kundrejt studentëve duke synuar përmirësimin e cilësisë së edukimit dhe lidhjen me tregun e punës.</p> <ul style="list-style-type: none"> • QKA komunikon programet e studimeve pranë shkollave të larta të rajonit. • Jep mbështetje mbi bursat apo oportunitete të tjera për studentët. • Shërben si urë lidhëse midis tregut të punës dhe studentëve, duke orientuar profilet e studentëve sipas kërkesave të kompanive, për zhvillimin e intershiveve apo praktikave profesionale. <p>Gjithashtu, QKA menaxhon edhe rrjetin ALUMNI, duke krijuar oportunitete edhe për studentët që janë në përfundim të studimeve të tyre, nëpërmjet vendosjes së kontakteve me studentët që kanë përfunduar tashmë studimet e tyre.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X


VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ vlerëson se institucioni është i pajisur me strukturat që garantojnë monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së brendshme duke përfshirë edhe programin Bachelor në “Menaxhim”. Njësia përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë është KSKC. Funkcioni i kësaj njësie është në përputhje të plotë të misionit të institucionit. KSKC si strukturë, është e paraparë në Statutin e UK-së (Aneksi I.01), duke ndjekur standardet e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Politika për sigurimin e cilësisë në UK është publike dhe është pjesë e Planit Strategjik të Zhvillimit të UK (Aneksi I.03).</p> <p>Manuali i Cilësisë UK (Aneksi I.16), përcakton kornizën, strukturat, parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në UK. Në manual, përcaktohet Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), si struktura që bën vlerësimin e brendshëm të cilësisë. Ajo përbëhet nga përfaqësues nga çdo njësi kryesore, SKSC, student dhe ekspert i jashtë. Pranë çdo njësie kryesore, me propozim të Dekanit, ngrehet një njësi NJSBC. Kjo përcaktohet edhe në rregulloren e FE (Aneksi I.27).</p> <p>UK përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL.</p> <p>Veprimtarinë e saj NJSBC-ja e mbështet në Manualin e Cilësisë UK (Aneksi I.16). Në mënyrë periodike NJSBC-ja raporton dhe informon drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore dhe përmes tyre të gjithë stafin e UK-së mbi rezultatet e monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.</p> <p>Këto raporte krahasohen me standardet e cilësisë të parashikuara Manualin e Cilësisë UK. Zbatimi i standardeve të cilësisë nënkupton zbatimin e standardeve akademike, kërkimore, menaxhuese, infrastrukture, etj me qëllim që të arrihen nivele maksimale në procesin mësimor dhe kërkimor.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni ngrë njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p> <p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> <p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>NJSBC-ja vepron në nivel institucional dhe është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë në të gjithë programet e studimit. Në funksion të garantimit të cilësisë, rol të rëndësishëm përveç NJSBC-së ka dhe Departamenti i Menaxhimit, si njësi përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Menaxhim”.</p> <p>Departamenti në fund të çdo viti akademik bën rishikimin e programit të studimit duke reflektuar të gjitha informacionet e mbledhura nga studimi i tregut (Aneksi I.22), rezultatet e sondazhit të studentëve dhe opinionet e pedagogëve. Përgjegjësi i Departamentit bën një relacion me ndryshimet (Aneksi II.11) dhe e paraqet për shqyrtim në Dekanat.</p> <p>Dekani merr parasysh ndryshimet dhe ia paraqet Senatit akademik për vendimin final. Ndryshimet e miratuara nga Senati, pasqyrohen në dokumentacionin mësimor.</p> <p>KSCK (Aneksi I.05) ja përdor metodologji dhe instrumente vlerësimi për ecurinë e programeve të studimit dhe aktiviteteve të tjera akademike.</p> <p>Gjithashtu, sekretaria mësimore mban të dhëna të tjera që kanë të bëjnë me arritjet e studentëve dhe të dhëna të ndryshme për to, të tilla si: arritjet e studentëve, karakteristika demografike të studentëve.</p> <p>NJSBC në shkallë institucioni informon Senatin të UK lidhur me rezultatet e vlerësimit dhe sugjerimet për përmirësim. NJSBC në shkallë njësie bën të njëjtën gjë me Dekanin. Këto raporte publikohen online dhe ruhen pranë Departamentit.</p> <p>Referuar RVB-së, GVJ konstaton se raportet e vlerësimit bazohen në krahasimin e rezultateve të pritshme me ato të vlerësimit të konstatuar si dhe në masat e marra për zgjidhjen e problemeve dhe përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë (Aneksi III.02). Rezultatet nga raportet e vlerësimit përfshijnë tregues të performancës së pedagogëve, rezultatet e mësimnxënies, etj.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ konkludon se vlerësimi nga NJSBC bëhet në nivel institucional dhe si i tillë shtrihet në të gjithë programet e studimit dhe nuk hartohen relacione specifike në bazë programi, por nga analiza e përgjithshme, secili nga departamentet përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit evidenton elementët që lidhen me programet specifike. Këto vlerësime janë pjesë e vetëvlerësimeve në kuadër të akreditimit institucional dhe programeve të studimit (Aneksi I.05).</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p> <p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni ndërmerr analiza të vlerësimit të cilësisë në disa drejtime. Kështu ai përdor instrumente të ndryshme për vlerësimin e cilësisë si analiza dhe përpunimi i raporteve dhe proces verbaleve të kontrollit në auditor, kontrollet e natyrave të tjera si dhe raporti vjetor i hartuar nga fakulteti dhe departamenti (Aneksi III.02).</p> <p>Kontrolli i mbarëvajtjes e cilësisë së programit, vlerësohet në disa shkallë. Në nivel njësie bazë, Përgjegjia e Departamentit bën verifikimet direkte duke biseduar me pedagogët mbi literaturën, mënyrat e vlerësimit të njohurive e deri tek metodika e dhënies nga pedagogu. Gjithashtu, verifikohen materialeve idaktike të lëndës që u vihet në dispozicion studentëve, vlerësimi i provimeve me objektivitet dhe në mënyrë të tillë që teza të paraqesë standardin e duhur për cilësinë e diplomës së kërkuar.</p> <p>Në nivel njësie kryesore, Dekani duhet të mbikqyr mbarëvajtjen mësimore (sipas Statutit UK - Aneksi I.01).</p> <p>Në nivel institucional, KSCK monitoron cilësinë e zbatimit të kurrikulës, dhe raporton në Rektorat mbi rezultatet e monitorimit.</p> <p>GJV konstaton se, institucioni përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista me studentët aktualë, me ato të diplomuar (alumni), me personelin akademik, ndihmës akademik e administrativ. Departamenti dhe FE, nëpërmjet metodave dhe instrumenteve të tërthorta nxjerrin konkluzione lidhur me cilësinë, për të ndikuar më pas në përmbushjen e standardeve të saj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>


Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> <p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Në Manualin e Cilësisë (Aneksi I.16), Rregullorja e FE (Aneksi I.27) dhe Rregullorja e DKSKC (Aneksi I.05), përcaktohen palët e angazhuara në realizimin e procesit mësimor cilësor. Kështu në UK, pedagogët janë jo vetëm realizues të procesit mësimor, por edhe si një faktor i rëndësishëm për rritjen e nivelit të cilësisë duke u angazhuar në përpunimin e rregulloreve dhe standardeve të ndryshme të cilësisë.</p> <p>Gjithashtu, përfaqësimi i studentëve është instrument i rëndësishëm që realizohet në mënyra të ndryshme, si tërheqja e mendimit nga këshilltarët akademikë, përfaqësimin e tyre në senat dhe në organe të tjera vendimmarrëse të institucionit.</p> <p>Studentët janë pjesëmarrës edhe në NJSBC, ku në rregulloren e kësaj njësie (Aneksi I.05), janë parashikuar detyra konkrete për njësitë, individët, studentët, pedagogët dhe palë të tjera të angazhuara për garantimin e cilësisë së programit të studimit. Kjo rregullore garanton përfshirjen e anëtarëve të personelit akademik si dhe të studentëve.</p> <p>Përfshirja e aktorëve të brendshëm siguron dhe respekton integritetin akademik si të pedagogëve ashtu edhe të studentëve. Bazuar në RVB, GVJ, konstaton se institucioni, garanton integritetin akademik dhe në praktikën e tyre nuk janë konstatuar raste të diskriminimit, të pabarazisë kundrejt stafit akademik dhe studentëve apo të dallimeve subjektive.</p> <p>Vlerësimi i cilësisë së proceseve që lidhen me programet e studimit parashikon edhe përfshirjen e palëve të treta të cilat me ekspertizën e tyre mund të japin mendime për përmirësimin e cilësisë së programit. GVJ nga shqyrtimi i RVB konstaton angazhimin e ekspertëve të jashtëm në procesin vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë. Ekspertiza e tyre ka qenë e vlefshme sidomos në përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, në aspektet e lidhjes së teorisë me praktikën. Mendimi i ekspertëve është tërhequr jo vetëm nëpërmjet angazhimit të tyre në mësimdhënie, por edhe në takime të ndryshme, në leksione të hapura, ëork-shope etj. (Aneksi I.36).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ konstaton se politikat dhe strategjia në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, janë të rregulluara në Politikat dhe strategjinë e zhvillimit të UK (Aneksi I.03), FE (Aneksi I.19) dhe Departamentit. Ndërsa organizimi dhe veprimtaritë gjenden në Statutin e UK (Aneksi I.01), Rregulloren e UK (Aneksi I.02), Manualin e Cilesise te UK (Aneksi I.16) dhe Rregullorrr.n e nrendshme te FE (Aneksi I.27).</p> <p>Këto informacione janë të aksesueshme nga faqja ëeb e UK.</p> <p>Institucioni publikon dhe bën transprante rezultatet e vlerësimit të NJBSC në faqen ëeb UK, si edhe ruhen pranë Departamentit dhe FE (Aneksi III.02). Program i transparencës në UK, është i lidhur me zbatimin e detyrimeve ligjore që parashikon neni 7 i ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe shikohet si një nevojë për të rritur shkallen e integritetit të stafit dhe përgjegjshmërinë institucionale të universitetit.</p> <p>Institucioni, analizat dhe raportet e ndryshme në lidhje me cilësinë dhe standardet e mësimdhënies dhe nxënies i shoqëron me plane masash për të përmirësuar problemet e konstatuara (Aneksi VI.02).</p> <p>Departamenti, FE dhe UK vlerësojnë në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive akademike. Ato synojnë realizimin e objektivave të cilësisë, duke arritur përmirësimin dhe duke reflektuar hap pas hapi në zgjidhjen e çdo problemi të konstatuar. Institucioni e vlerëson efektivitetin e programit të lidhur ngushtë me aftësimin e studentëve për të realizuar objektivat dhe pritshmëritë e tyre në përfundim të kursit. Një nga funksionet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë është të komunikojë rezultatet dhe të ndërgjegjësojë palët e ndryshme të interesit për hapat e ndërmarra për rritjen e cilësisë në të gjitha drejtimet.</p> <p>Institucioni kryen takime informuese me studentët të të gjitha cikleve dhe të këtij programi në funksion të nevojës për plotësimin sa më të mirë të cilësisë, si kusht që diploma dhe njohuritë e tyre të jenë të vlefshme, bashkëkohore dhe afat gjata.</p> <p>Objektiv i rëndësishëm ka qene jo vetëm informimi dhe pjesëmarrja e studentëve dhe pedagogëve në procesin e ndërgjegjësimin, por edhe pjesëmarrja e tyre në përmirësimin e cilësisë së programeve të mësimin.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Menaxhim” të institucionit të arsimit të lartë “Fan S. Noli”, Korçë.

Pikat e forta dhe afirmime:



1. Jetëgjatësia e programit të studimit dhe konsolidimi i tij në kohë.
2. Përshtatja e programit të studimit me nevojat e rajonit bazuar dhe në marrëdhëniet e forta që janë mbajtur me faktorët kyç të tregut të punës.
3. Universiteti i “Fan S. Noli” dhe specifikisht FE, ka kapacitetet dhe infrastrukturën për orientimin dhe informimin e studentëve.
4. Përqasja mjaft pozitive dhe mbështetëse ndaj studentëve.
5. Bashkëpunimi ndërkombëtar nëpërmjet projekteve të ndryshme.

Pika të dobta:

1. Jo të gjithë titullarët e lëndëve i përkasin kategorisë Profesor, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.
2. Numër i kufizuar modulesh që zhvillohen me praktika laboratorike.

Rekomandime:

1. Për të përmbushur kriteret ligjore, FE duhet të marrë masat e duhura për mbulimin e moduleve me titullarë të kategorisë Profesor.
2. Të rriten përpjekjet e stafit pedagogjik në mënyrë që të realizohen edhe module të tjera me praktika laboratorike.
3. Universiteti i “Fan S. Noli” duhet të rrisë transparencën lidhur me raportet financiare të cilat diskutohen në organet kolegjiale të UK: Rektorat, Bord Administrimi dhe Senat.



Conclusions of the evaluation of the first cycle study program, Bachelor in “Management” of the University “Fan. S. Noli”, Korca

Strengths and Affirmations:


1. Consolidation in time of the study program.
2. Adapting the study program to the needs of the region based on the strong relationships that have been maintained with key labor market factors.
3. The University “Fan S. Noli” and specifically FE, has the capacity and infrastructure for orientation and information of students.
4. Very positive and supportive approach towards students.
5. International cooperation through various projects

Weaknesses:

1. Not all course contact persons/lectures belong to the “Professor” category, according to the legal provisions in force.
2. Limited number of modules that use laboratory practices.

Reccomendations:

1. In order to meet the legal criteria, the FE must take the necessary measures to cover the modules with contact persons/lectures of the “Professor” category.
2. Th University should increase the efforts of the pedagogical staff in order to realize other modules with laboratory practices.
3. The University “Fan S. Noli” should increase the transparency regarding the financial reports which are discussed in the collegial bodies of the UK: Rectorate, Board of Administration and Senate



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

